



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

KODI I TRANSMETIMIT

PËR MEDIAT AUDIOVIZIVE

(Miratuar me Vendimin e AMA-s, nr. XX , datë XX)

PROJEKT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

HYRJE

Kodi i Transmetimit përmban dhe përcakton parimet, rregullat, kërkesat dhe praktikën e transmetimeve audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Kodi i Transmetimit është hartuar në zbatim të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Struktura dhe përmbajtja e Kodit të Transmetimit mbështeten në parimet themelore të veprimtarisë së transmetimeve audiovizive, në standardet më të arrira profesionale bashkëkohore, në normat, kërkesat morale dhe etike, si dhe në praktikën e deritanishme të veprimtarisë audiovizive në Republikën e Shqipërisë.

Ky Kod Transmetimi mban parasysh rolin e rëndësishëm të Ofruesve të Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA), si mjete të pavarura informacioni dhe platforma mediatike të zhvillimeve publike, politike e shoqërore, që kryejnë funksion informativ, kulturor, argëtues dhe edukativ, si dhe rolin e funksionin e AMA-s si autoritet rregullator në fushën e transmetimeve audiovizive.

Kodi i Transmetimit zbatohet nga OSHMA- të publike, private, tregtare ose jotregtare, pavarësisht mënyrës së shpërndarjes së shërbimit, tokësore, satelitore, me kablo, TV në internet, ose në ndonjë formë tjetër, qofshin kombëtarë, rajonalë, vendorë ose ndërkufitarë.

Kodi i Transmetimit ka për qëllim të sigurojë pavarësinë dhe paanësinë e veprimtarisë së OSHMA-ve, duke synuar që ato të bëhen gjithnjë e më të ndërgjegjshme për rolin dhe përgjegjësinë e tyre në transmetimin e programeve, në përputhje me respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, me standardet e parimet etike e morale të shoqërisë, me respektimin në mënyrë të veçantë të të drejtave të fëmijëve për të qenë të mbrojtur, për t’u shprehur dhe për t’u informuar, në respektimin e privatësisë, dinjitetit, pluralizmit, paanësisë etj.

Kodi i Transmetimit u rishikua nga AMA e cila përgjegjëse për hartimin dhe rishikimin e KT bazuar në parashikimet e nenit 46, paragrafi i i ligjit nr. 97/2013. Nga ndryshimet e fundit të tij të miratuara në vitin 2017, një sërë ndryshime ligjore që ndikojnë në fushën e transmetimeve audiovizive janë miratuar dhe nga ana tjetër, probleme serioze vërehen në praktikën e transmetimit përse i përket respektimit të të drejtave të njeriut.

Direktiva 2010/13 e Bashkimit Evropian dhe Parlamentit Evropian “Për Shërbimet Mediatike Audiovizuale” e ndryshuar nga Direktiva 2018/1808 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 14 Nëntor 2018, ndonëse nuk është e detyrueshme për Shqipërinë, në kuadër të marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit dhe nevojës së adresimit të problemeve që hasen në realitetin shqiptar, përafrimi i legjislacionit shqiptar me Direktivën e përditësuar dhe praktikën e mira të adresimit të problemeve që shfaqen do të ishte e rekomandueshme të mbahej parasysh gjatë rishikimit të legjislacionit dhe KT.

Rishikimi i KT u bazua në nevojat e pasqyrit të standardeve të reja minimale të miratuara nga institucionet e evropiane në lidhje me mediat audiovizive në kushtet e reja të teknologjisë, standardet e përcaktuara nga legjislacioni shqiptar nga momenti i miratimit të Kodit të Transmetimit (2014), sugjerimet e institucioneve ndërkombëtare, përfshirë Komisionin e Venecias, jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nevojën e adresimit të problemeve të dala në praktikë.

Në thelb, Kodi i Transmetimit përmban parimet bazë të transmetimit, si dhe rregullon veprimtarinë audiovizive, pothuaj në të gjithë gamën e saj të shumanshme e të larmishme. Kodi është strukturuar në seksione që përfshijnë parime e rregulla për programet informative, për mbrojtjen e fëmijëve në programet e të gjitha llojeve, promovimin e barazisë gjinore dhe parandalimin e diskriminimit gjinor në media, përfshirë seksizmin, parandalimin e gjuhës së urrejtjes, të drejtat e personave me nevojë të veçantë, për komunikimet e ndryshme tregtare, respektimin e dinjitetit, mbrojtjen e të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

dhënave personale.

Gjatë rishikimit të tij, Kodi i Transmetimit u pasuria me parime dhe rregulla të reja për promovimin e barazisë gjinore, parandalimin e diskriminimit gjinor dhe luftimin e seksizmit në mediat audiovizive; parandalimi i gjuhës së urrejtjes, nxitjes së ekstremizmit, radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, mbrojtjen më të mirë të të drejtave dhe lirive të njeriut, pavarësisht statusit ose pozitës sociale të tij, aksesit në median audiovizive dhe mbrojtja e të drejtave të personave me nevoja të veçanta. Fëmijët dhe media është rishikuar me qëllim përditësimin e Kodit të Transmetimit me standardet më të lartë për mbrojtjen e fëmijës, por edhe [ër të adresuar mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës në të gjitha programet e transmetimit.

Baza ligjore mbi të cilën është rishikuar Kodi i Transmetimit është zgjeruar dhe pasuruar me aktet ndërkombëtare detyruese ku shteti Shqiptar është palë dhe legjislacionin rekomandues të veçantë në fushë. Gjithashtu, legjislacioni shqiptar është përditësuar me ligjet që rregullojnë aspekte të parashikuara nga ligji për median audiovizive dhe Kodi i Transmetimit.

Parimet dhe rregullat e Kodit të Transmetimit zbatohen në harmoni me rregullat që përcakton kodi në tërësi, por edhe me Kodet e Sjelljes që hartohen nga OSHMA-të. Rishikimi i Kodeve të Sjelljes për reklamat, ushqimet dhe pijet nga çdo OSHMA është i nevojshëm me hyrjen në fuqi të këtij Kodi. Ekspertiza e AMA-s, Këshillit të Ankesave, organizatave vendase në fushë, ekspertëve të pavaruar të institucioneve të arsimit të lartë që kanë në strukturat e tyre departamente të komunikimit dhe medias janë të mirëpritura dhe të bazuara në ligji. Konsultimi me organizata dhe institucione ndërkombëtare që veprojnë në fushë janë të nevojshme për kuptimin dhe zbatimin e të drejtë të Kodit të Transmetimit dhe rritjen e kapaciteteve të gazetarëve dhe stafit të medias.

Rregullat e Kodit të Transmetimit nuk duhet të lexohen ose të zbatohen nga OSHMA-të në mënyrë të veçuar, por brenda kontekstit të Kodit në tërësi, të lidhura ngushtë me rregullave që parashikohen në të.

BAZA LIGJORE

1. Kodi i Transmetimit, i hartuar dhe i miratuar nga AMA, sipas detyrimit të parashikuar në nenin 46 të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, vendos rregullat, standardet dhe praktikat e transmetimit në përputhje me përcaktimet e akteve ligjore dhe nënligjore të mëposhtme:
 - Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;
 - Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
 - Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;
 - Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
 - Ligji nr. 8096, datë 21.03.1996 “Për kinematografinë”, i ndryshuar;
 - Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar;
 - Ligji nr. 9970, datë 27.7.2008 “Për barazinë gjinore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
 - Ligji nr.93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”
 - Ligji nr.8528, datë 23.9.1999 “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji”
 - Ligji nr. 9518, datë 18.4.2006 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”, i ndryshuar¹
 - Ligji nr.9636, datë 6.11.2006 për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, i ndryshuar²
 - Ligji nr. 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
 - Ligji nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar;
 - Ligji nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”
2. Kodi i Transmetimit është hartuar në bazë të kërkesave që lidhen me veprimtarinë audiovizive në Bashkimin Europian, parashikuar nga Direktiva 2010/13 e BE-së (“Audiovisual Media Services Directive”).
3. Kodi i Transmetimit është hartuar në zbatim të akteve ndërkombëtare për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut:
 - Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore, (e vitit 1998), neni 8, neni 9, neni 10 dhe neni 14 dhe protokollet 12 i saj

¹ Ligj nr. 74/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9518, datë 18.4.2006, “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”, të ndryshuar përmban risi në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve në mediat audiovizive

² Ligji i përditësuar gjenden në adresën zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë:
<https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20191025095557Ligji%20per%20mbrojtjen%20e%20shendetit%20nga%20produktet%20e%20duhanit.pdf>. (Faqja është vizituar më datë 5.03.2022).

- Konventa e OKB-së “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” (1989)
 - Konventa e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual (Konventa e Lazarotes)³
 - Konventa e Këshillit të Evropës për krimin kibernetik⁴ dhe protokoli shtesë i saj⁵.
 - Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial;
 - Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) , 2011
 - Konventa e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar
4. Kodi i transmetimit është hartuar duke në zbatim të rekomandimeve ndërkombëtare në fushëm, ndër të cilat:
- Rekomandimi CM/Rec(2022)16 I Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare për luftimin e gjuhës së urrejtjes⁶
 - Rekomandimi i përgjithshëm (2021) i GREVIO-s “Për dimensionin dixhital të dhunës kundër grave;⁷
 - Rekomandimi (2019)1 i Komitetit të Ministrave të vendeve anëtare të Këshillit të Evropës CM/Rec(2019) për parandalimin dhe luftimin e seksizmit;⁸
 - Rekomandimi Rec (2007)17 i Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare standardet dhe mekanizmat e barazisë gjinore;⁹
 - Rekomandimi Rec (2017)9 i Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare mbi barazinë gjinore në sektorin e medias audiovizive.¹⁰
 - Rekomandimi i Politikës së Përgjithshme të ECRIT (2015) 15 “Mbi luftimin e gjuhës së urrejtjes”;

³ Konventa e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual. Konventa gjendet në internet në adresën: <https://rm.coe.int/168046e1e3>. (Faqja u vizitua më datë 5.03.2022).

⁴ Konventa është ratifikuar me ligjin nr.8888, datë 25.4.2022. Përmbajtja e konventës është e disponueshme në adresën: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2002/04/25/8888>.

⁵ Ligji nr. 9262, datë 29.7. 2004 Për ratifikimin e “Protokollit shtesë të konventës për krimin kibernetik, për penalizimin e akteve me natyrë raciste dhe ksenofobe të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike”. Përmbajtja e konventës është e disponueshme në adresën: www.pp.gov.al/rc/doc/protokolli_shtese_i_konventes_per_krimin_kibernetik_1371.pdf.

⁶ https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=0900001680a67955

⁷ GREVIO General Recommendation No. 1 on the digital dimension of violence against women miratuar më 20 Tetor 2021. Rekomandimi gjendet në internet në adresën: <https://rm.coe.int/grevio-rec-no-on-digital-violence-against-women/1680a49147>.

⁸ Recommendation CM/Rec (2019)1 of the Committee of Ministers to member States on preventing and combating sexism. Rekomandimi gjendet në internet në adresën: <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168093b26a>

⁹ Recommendation CM/Rec(2007)17 on gender equality standards and mechanisms. Rekomandimi gjendet në internet në adresën:

¹⁰ CM/Rec(2017)9 on gender equality in the audiovisual sector. Rekomandimi gjendet në internet në adresën:

- Rekomandimi 165(2004) i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës “Për të drejtën e përgjigjes në mjedisin e ri të medias;
- Rekomandimi R (90) 4 i Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare për eliminimin e seksizmit nga gjuha;¹¹

Strategjitë kombëtare

- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030¹²
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar (2021- 2025)
- Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës (2021-2026)
- Plani Kombëtar i Veprimit për personat LGBTI (2021-2027)

¹¹ Recommendation No R (90) 4 on the elimination of sexism from language Rekomandimi gjendet në internet në adresën:

¹² Për më shumë shih: “Strategjia Kombëtare për barazinë gjinore 2021-2030”
<https://www.google.com/search?q=Strategjia+Kombëtare+për+barazinë+gjinore+2021-2030&aq=chrome..69i57.1891j0j15&sourceid=chrome&ie=UT>

PËRKUFIZIME

Temat e mëposhtëm kanë këto kuptime në Kodin e Transmetimit:¹³

- Barazi gjinore” është pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe e meshkujve në të gjithat fushat e jetës, pozita e barabartë ndërmjet tyre, mundësi e shanse të barabarta, për të gëzuar të drejtat dhe për të përmbushur detyrimet në shoqëri, duke përfituar njëloj nga arritjet e zhvillimit të saj.
- “Denigrim” nënkupton sulmin ndaj kapacitetit, personalitetit ose reputacionit të një ose më shumë personave në lidhje me anëtarësimin e tyre në një grup të caktuar personash.
- “Diskriminim nënkupton çdo trajtim të ndryshëm mbi bazën e shkaqeve si "raca", ngjyra, gjuha, feja, kombëtare ose përkatësia kombëtare ose etnike, si edhe prejardhja prindërore, besimi, seksi, gjinia, identiteti gjinor, orientimi seksual apo karakteristika të tjera ose statusi, që nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.
- “Diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar nënkupton çdo dallim, përjashtim ose kufizim për shkak të aftësisë së kufizuar, që ka si qëllim ose ndikon në pengimin ose mohimin e njohjes, gëzimit ose ushtrimit, njësoj si gjithë të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile apo në ndonjë fushë tjetër. Në këtë përkufizim përfshihen të gjitha format e diskriminimit, duke përfshirë edhe mohimin e përshtatjes brenda logjikës;
- “Diskriminim për shkak të gjinisë” është çdo dallim, përjashtim ose kufizim mbi baza gjinore, që ka për qëllim ose për pasojë dëmtimin, mosnjohjen, mosgëzimin dhe mosushtrimin, në mënyrë të barabartë, nga secila gjini, të të drejtave të njeriut dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligje, në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e civile.
- “Dhuna me bazë gjinore është dhuna ndaj një personi për shkak të gjinisë së tij ose të saj dhe pritshmërive ndaj rolit të tij ose të saj në shoqëri ose culture.
- Dhunë ndaj gruas është çfarëdolloj akti i dhunës me bazë gjinore që shpie ose ka gjasa të shpjerë drejt vuajtjes ose dëmit psikologjik, seksual ose fizik të grave, duke përfshirë kërcënimet për këto akte, kanosjen ose mohimin e paarsyeshëm të lirisë, ose në jetën publike ose atë private
- “Fëmijë” është çdo person nën moshën 18 vjeç.
- “Gjuhë asnjansë gjinore¹⁴” nënkupton gjuhën që nuk është specifike për gjininë dhe që i konsideron njerëzit në përgjithësi.

¹³ Përkufizimet në lidhje me gjuhën e urrejtjes janë marrë nga fjalori i ECRI-t, i botuar në shqip, Shkurt 2021; përkufizimet në lidhje me barazinë gjinore dhe diskriminimin gjinor janë marrë nga fjalori **xx** Termat e tjerë në Kodin e Transmetimit janë marrë nga ligji nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

¹⁴ <https://eige.europa.eu/thesaurus/terms/1191?lang=sq>

- “Gjuhë e djeshme gjinore” është realizimi i barazisë gjinore në gjuhë të shkruar dhe të folur kur gratë dhe burrat dhe ato që nuk përputhen me sistemin binar gjinor bëhen të dukshme dhe adresohen në gjuhë si persona me vlerë të njëjtë, dinjitet, integritet dhe respekt.¹⁵

Varianti A

- “Gjuha e urrejtjes” është çdo formë e shprehjes në publik me çdo mjet e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose për çdo shkak tjetër
- “Interesi më i lartë i fëmijës” është e drejta e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për të¹⁶.
 - Interesi Publik përfshin: çështjet, që përbëjnë shqetësim urgjent dhe të menjëhershëm për shëndetin dhe sigurinë publike; gjetja, parandalimi dhe publikimi i krimeve të rënda, skandaleve dhe abuzimeve të pushtetit dhe veprimet për të mbrojtur publikun nga rreziku i çorientimit të rëndë. Interesi publik legjitim nuk justifikon sensacionalizmin dhe nuk duhet ngatërruar kurrë me informacionin që është “interesant për publikun.”¹⁷
- “Nxitja ose ndihma për diskriminim” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një ose më shumë persona nxisin ose ndihmojnë një ose më shumë persona të tjerë, duke përfshirë edhe financimin e tyre me qëllim për të diskriminuar bazuar në cilindo shkak të përmendur në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi. ligji “Këshilli i Ankesave” është struktura e ngarkuar me mbikëqyrjen e respektimit të Kodit të Transmetimit, sipas përcaktimeve të nenit 20 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- “Komunitet me nevoja të veçanta shqisore” është komuniteti me mangësi të pjesshme ose të plotë shikimi ose dëgjimi, aftësia e të cilëve për të perceptuar sinjale audio apo audiovizive është e kufizuar në atë masë që bën të pamundur gëzimin e së drejtës së informimit.
- “Përmbajtje e dëmshme për fëmijën” është çdo pamje, imazh apo çdo material tjetër që qarkullon në internet dhe që cenon dinjitetin dhe të drejtat e fëmijës¹⁸.
- “Përgjegjësi editoriale” është ushtrimi i kontrollit efektiv mbi përzgjedhjen e programeve dhe organizimin e tyre në një listë dhe orar, në rastin e shërbimeve të transmetimit të drejtpërdrejtë

¹⁵ <https://eige.europa.eu/thesaurus?lang=sq>

¹⁶ Sipas ligjit 37/2017.

¹⁷ Sipas Kodit të Etikës (përkufizimi i Këshillit Shqiptar të Medias)<https://kshm.al/wp-content/uploads/2018/04/Kodi-i-Etikës-final-shqip-3.pdf>

¹⁸ Bazuar në përkufizimin e dhënë në nenin 3, pika 11, të ligjit nr. 37/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

audioviziv dhe në një katalog, në rastin e shërbimeve të programit audioviziv, sipas kërkesës.

- “Program radio” është tërësia e mesazheve audio që përbëjnë një element individual brenda një liste apo katalogu të krijuar nga ofruesi i shërbimit, forma dhe përmbajtja e të cilit janë të krahasueshme me formën dhe përmbajtjen e transmetimit radio.
- “Program televiziv” është tërësia e imazheve lëvizëse, me ose pa zë, që përbëjnë një element individual brenda një liste apo katalogu të krijuar nga ofruesi i shërbimit, forma dhe përmbajtja e të cilit janë të krahasueshme me formën dhe përmbajtjen e transmetimit televiziv. Shembujt e programeve përfshijnë filma, ngjarje sportive, komedi, dokumentarë, programe për fëmijë dhe drama origjinale.
- “Radikalizim” është procesi i brendësimit të qasjeve ekstreme politike, fetare ose sociale të cilat bien në kundërshtim me vlerat e një shoqërie demokratike.
- “Racizëm” është besimi se motive, si "raca", ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia, origjina etnike ose kombëtare, justifikojnë përbuzjen ndaj një personi ose kategorie dhe/ose superioritetin e një personi apo një kategorie.
- “Reklamë” është çdo formë e publikimit të transmetuar kundrejt pagesës ose përfitimeve të tjera nga një sipërmarrje publike ose private apo nga një person për qëllime vetëreklamuese, lidhur me veprimtari të veta tregtare e fitimprurëse, profesionale ose ekspertizë, si dhe për mbështetjen e pajisjes me mallra ose shërbime, përfshirë këtu pasuri të paluajtshme, të drejta e detyrime të tjera, përkundrejt pagesë.
- “Seksizëm është çdo akt, gjest, paraqitje vizuale, fjalë të folura ose të shkruara, praktikë ose sjellje e bazuar në idenë se një person ose një grup personash është inferior për shkak të seksit të tyre, që ndodh në sferën publike ose private, qoftë online ose offline, me qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit ose të drejtave të qenësishme të një personi ose një grupi personash ose që rezultojnë në dëm fizik, seksual, psikologjik ose socio-ekonomik ose vuajtja e një personi ose një grupi personash; ose duke krijuar një kërcënim frikësues, armiqësor, poshtërues, poshtërues ose ofendues mjedisi; ose që përbën një pengesë për autonominë dhe realizimin e plotë të të drejtave të njeriut nga një person ose një grup personash; ose ruajtjen dhe përforcimin e stereotipeve gjinore.
- “Stigmatizim” është nënkupton etiketimin e një grupi personash në një mënyrë negative.
- “Steriotip gjinor” - paragjykim, sipas të cilit femrave dhe meshkujve u paracaktohen në mënyrë arbitrare karakteristika dhe role të kufizuara sipas gjinisë¹⁹.
- “Shprehja” -përfshin fjalë dhe publikime të çfarëdo forme, përfshirë edhe ato përmes medias elektronike përfshirë përhapjen dhe ruajtjen e tyre. Gjuha e urrejtjes mund të marrë formën e fjalëve të shkruara ose të shqiptuara, ose forma të tjera si foto, imazhe, shenja, simbole, piktura, muzikë,

¹⁹ <https://eige.europa.eu/thesaurus/terms/1222?lang=sq>

pjesë teatrale ose video. Shprehja përfshin edhe përdorimin e një sjelljeje të caktuar - sipsh. gjestet - për të komunikuar një ide, mesazh ose mendim.

- “Shqetësim” – në kuptimin e këtij Kodi - është ajo gjendje psiko-emocionale, e përftuar si pasojë e diskriminimit, të lidhur me cilindo prej motiveve të përmendura në legjislacionin përkatës për mbrojtjen nga diskriminimi, me qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për të si edhe trajtimin e pafavorshëm të personit të cenuar në rast kundërshtimi apo mosnënshtrimi të tij ndaj një qasjeje të tillë.
-
- “Ofrues shërbimi mediatik audioviziv (OSHMA)” është personi fizik ose juridik, që ka përgjegjësinë editoriale për zgjedhjen e përmbajtjes së shërbimeve të transmetimit audioviziv dhe që vendos mënyrën e organizimit të saj.

Termat e tjerë në Kodin e Transmetimit kanë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PARIMET THEMELORE²⁰

Parimet themelore që përbëjnë bazën e zhvillimit të veprimtarisë audiovizive, e cila mbështetet në garantimin e lirisë dhe të pluralizmit të mjeteve të komunikimit audioviziv janë si më poshtë vijon:

- 1.1 Operatorët e shërbimit mediatik audioviziv, gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre, **respektojnë, garantojnë dhe promovojnë** liritë dhe të drejtat e njeriut, lirinë e shprehjes, të drejtën e informimit, parimin e mosdiskriminimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.
- 1.2 Veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton rendin kushtetues, sovranitetin dhe integritetin kombëtar.
- 1.3 Transmetimet audiovizive respektojnë **dinjitetin njerëzor, personalitetin** dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut.
- 1.4 Veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesin më të lartë të fëmijësi dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.
- 1.5 Transmetimet audiovizive duhet të promovojnë dhe të mbrojnë mirëqenien, shëndetin e zhvillimin harmonik moral e fizik të fëmijëve. Parimi i interesit më të lartë për mbrojtjen e fëmijës duhet të jetë parësor në çdo vendimarrje për transmetimin, programimin, përfshirjen e tyre ose informimin për ta pjesëmarrjen ose informacionet për ta, në mediat audio dhe/ose audiovizive.
- 1.6 Transmetimet audiovizive, që përmbajnë elementë të pornografisë ose dhunës së skajshme, duhet t'u nënshtrohen rregullave të veçanta të një sistemi kontrolli, si ai i aksesit të kushtëzuar ose programeve të krijuara. Asnjë përmbajtje pornografike nuk duhet të transmetohet në oraret kur programet ndiqen prej fëmijëve²¹.
- 1.7 ²².
- 1.8 Transmetimet audiovizive nuk duhet të përdorin gjuhë që përhap, promovon ose nxit në çfarëdoq formë urrejtjen, denigrimin ose përgojimin e një personi apo grupi personash, nuk duhet të përdorin asnjë formë ngacmimi, fyerjeje, stereotipizimi negativ, stigmatizimi ose kërcënimi të një personi apo personave të tillë si edhe asnjë justifikim të të gjitha këtyre formave të shprehjes sipas "racës", ngjyrës, gjuhës, fesë/besimit, kombësisë/prejardhjes kombëtare apo etnike, prejardhjes prindërore, moshës, aftësisë së kufizuar, seksit, gjinisë, identitetit gjinor apo orientimit seksual si edhe karakteristikave ose statuseve të tjera personale
- 1.9
- 1.10 Transmetimet audiovizive të të gjitha llojeve respektojnë dhe promovojnë të drejtën e barazisë dhe të mosdiskriminimit, **në mënyrë të veçantë barazinë dhe drejtësi gjinore në shoqëri, parandalojnë dhe luftojnë diskriminimin, stereotipet gjinore dhe seksizmit në shoqëri dhe media.**
- 1.11 Transmetimet audiovizive nuk duhet të promovojmë, nxisim ose të justifikojnë dhunën ndërmjet shtetasve, në veçanti dhunën me bazë gjinore.²³
- 1.12 OSHMA-të duhet të garantojnë që transmetimet audiovizive informative, argëtuese ose të natyrave të tjera të mos përmbajnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të nënkuptuar mesazhe diskriminuese për shkaqe si: gjinia, raca, mosha, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi

²⁰ Shtesat dhe në ndryshimet në tekst janë të theksuara.

²¹ Sugjeroj të ndryshojë" asnjë program me përmbajtje pornografike nuk transmetohet në oraret 6:00- 22:00.

²² Paragraf i ri.

²³ Paragraf i ri.

- seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, pozita arsimore ose shoqërore ose çdo shkak tjetër²⁴.
- 1.13 OSHMA-të distancohen, ndërpresim menjëherë transmetimin ose nuk transmetojnë kur gjenden përpara situatave të mbrojtjes, promovimit ose nxitjes në çdo formë të denigrimit, urrejtjes, stigmatizimi ose kërcënimit në lidhje me këtë person ose grup personash dhe justifikimit të të gjitha llojeve të shprehjes, bazuar në racë, ngjyrë, prejardhje, origjinë kombëtare ose etnike, moshë, aftësi, orientim seksual ose identitet gjinor.
- 1.14 Veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton të drejtat **dhe lirinë e personave me aftësi të kufizuar, veçanërisht të komuniteteve me nevoja të veçanta shqisore, për të kërkuar, patur dhe përhapur informacionin dhe idetë në baza të barabarta me të tjerët, nëpërmjet të gjitha formave të komunikimit dhe teknologjisë së aksesueshme e të përshtatshme për lloje të ndryshme të aftësisë së kufizuar, në kohën e duhur dhe pa kosto shtesë**²⁵.
- 1.15 Veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton normat morale dhe etike të shoqërisë, si dhe kërkesat e deontologjisë së profesionit të gazetarit.
- 1.16 Në transmetimet audiovizive respektohen të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to.
- 1.17 Në të gjithë llojet e transmetimeve audiovizive respektohet standardi letrar i gjuhës shqipe.
- 1.18 Transmetimet audiovizive respektojnë privatësinë, **të dhënat personale** dhe garantojnë të drejtën e përgjigjes.
- 1.19 Transmetimet audiovizive realizojnë një larmi përmbajtjeje dhe informacioni, duke respektuar lirinë e konkurrencës dhe shfrytëzuar mundësitë e zhvillimit teknologjik.
- 1.20 Operatorët e shërbimit mediatik audioviziv janë të hapur ndaj ideve, opinioneve, tendencave e kahjeve të ndryshme politike, shoqërore, kulturore e fetare.
- 1.21 Transmetimet audiovizive ruajnë, **zhvillojnë** dhe promovojnë **shumëllojshmërinë kulturore, veçanërisht kulturën, identitetin, traditat, trashëgiminë kulturore, artistike e mjedisore të pakicave kombëtare, në nivel kombëtar dhe vendor.**
- 1.22 Transmetimet audiovizive promovojnë kulturën e tolerancës, dialogut dhe mosdiskriminimit, përforcojnë mesazhet pozitive, respektin e ndërsjelltë, mirëkuptimin dhe bashkëpunimin pa dallim përsa i përket identitetit etnik, kulturor, gjuhësor ose fetar²⁶.
- 1.23 Transmetimet audiovizive shmangin përdorimin e gjuhës sensacionale ose provokuese, stigmatizimin e komuniteteve të veçanta, nuk përdorin gjuhë që promovon radikalizimin, ekstremizmin dhe terrorizmin apo që nxit urrejtjen e ngrindjet për shkak të etnisë, besimit fetar, identitetit gjinor, orientimit seksual.²⁷

²⁵ Paragraf i ri.

²⁶ Paragraf i ri.

²⁷ Paragraf i ri.

SEKSIONI 2²⁸

E DREJTA PËR PRIVATËSI DHE MBROJTJE TË TË DHËNAVE PERSONALE

- OSHMA-të duhet të respektojnë jetën private dhe familjare, shtëpinë, shëndetin dhe korrespondencën e çdo personi. (paragraf i ri)
- OSHMA duhet të respektojë të drejtën e çdo personi për të mbrojtur të dhënat e tij personale gjatë përpunimit të tyre për qëllime gazetareske, letrare ose artistike. (paragraf i ri)
- Shpërndarja e informacionit te publiku, përfshirë fotografitë për jetën private të personit pa pëlqimin e tij, është e pranueshme vetëm nëse një interes i ligjshëm publik tejkalon të drejtën e tij për privatësi dhe/ose mbrojtjen e të dhënave personale, gjithmonë duke u bazuar në mjaftueshmërinë e të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit ose publikimit të të dhënave dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim përgjatë pasqyrit të çështjes. (paragrafi 3.1)
- Gazetari duhet të sigurohet që informacioni i dhënë të jetë i saktë, i paraqitur në mënyrë të drejtë dhe objektive, veçanërisht kur përfshin zbulimin e aspekteve të jetës private ose të të dhënave personale të një personi. (paragrafi 3.1)
- Përfshirja në jetën publike nuk e përjashton personin nga e drejta për privatësi, përveç rasteve kur rrethanat e tij mund të ndikojnë në performancën ose në përshtatjen me rolet publike që mban ose kërkon. (paragrafi 3.1)
- Identifikimi i një biznesi ose i një personi në mënyrë indirekte ose aksidentale gjatë raportimit të një ngjarjeje me interes publik mund të publikohet, përveç rasteve kur vërtetohet se publikimi mund të shkaktojë dëm direkt ose paragjykim ndaj tij. **Gazetari, fotografi ose kameramani, gjatë dokumentimit me fotografi ose video të fakteve të kronikës, të cilat ndodhin në vende publike, duhet të shmangë fokusimin te personi/at ose detajet e tij/tyre, nëse publikimi i këtyre pamjeve nuk ka lidhje ose tejkalon qëllimin informues apo investigues të kronikës ose/dhe deontologjinë e profesionit të gazetarit.** (paragrafi 3.2, riformuluar).
- Përveç rasteve me interes të lartë publik, OSHMA-të nuk duhet të transmetojnë imazhe ose fotografi të personit të arrestuar në pranga, pa pëlqimin paraprak të tij²⁹. (paragrafi 3.3)
- OSHMA-të nuk duhet të bëjnë publik identitetin e personit që ka humbur jetën, ose që është përfshirë në aksident, përveç rasteve kur zbulimi/publikimi i i identitetit i shërben familjes ose hetimit. (bazuar në paragrafin 3.3)
- OSHMA-të duhet të respektojnë të drejtën e personit për privatësi kur raportojnë për grupet e pambrojtura të popullatës ose për situata sëmundjeje, fatkeqësie ose tragjedie. Gazetari duhet të shmangë çdo formë ngacmimi, ndërhyrje të lirë dhe spekulimi dhe ekspozimi të pajustificuar, që mund të rrisë dhimbjen dhe shqetësimin e personit/ave që është/janë përfshirë. (Bazuar në

²⁸ Në kodin e transmetimit në fuqi është seksioni 3. Numërtimi i paragrafëve të Kodit do të bëhet në përfundim të konsultimit publik dhe në variantin përfundimtar të integruar të tij.

²⁹ Sugjeruar nga Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale. Zëvendësimi i termit bëhet për të qenë në harmoni me terminologjinë e ligjit nr. 9887/2008 dhe udhëzimit nr.9, datë 15.9.2010 të Komisionerit.

paragrafin 3.3)

- OSHMA-të duhet të respektojnë parimin e prezumimit të pafajësisë, derisa personi të jetë dënuar me një vendim të formës së prerë. Kjo nuk duhet të pengojë OSHMA-të të raportojnë në mënyrë të drejtë mbi çështjet me interes publik, duke respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë. (paragrafi 3.4)
- Interesi publik përfshin, por nuk kufizohet vetëm në:
 - a) zbulimin ose ekspozimin e krimit ose të padrejtësisë serioze;
 - b) mbrojtjen e shëndetit publik dhe të sigurisë;
 - c) parandalimin e publikut nga mashtrimi me veprim ose deklaratë të një individi apo organizate;
 - d) garantimin e aksesit në informacione, që lehtësojnë formimin e opinionit të qytetarëve për çështjet politike, ekonomike dhe sociale. Për qëllimet e këtij Kodi, interesi publik, nuk duhet të justifikojë pasaktësitë dhe spekulimet.
- OSHMA-të duhet të respektojnë të drejtën e privatësisë kur japin të dhëna e informacione në lidhje me personin e dyshuar, të akuzuar apo të dënuar ose për subjekte të tjerë të lidhur me të në proces gjyqësor. (paragrafi i ri)
- OSHMA-të gjatë raportimit të një krimi nuk duhet të identifikojnë të afërmit ose të njohurit e personit të akuzuar ose të dënuar pa pëlqimin e tij. Gazetarët, me përjashtim të rasteve kur ekzistojnë pengesa specifike, mund të bëjnë publike të dhënat e të afërmeve dhe të njohurve të personit të dyshuar, akuzuar ose të dënuar që rezulton drejtpërdrejtë i përfshirë në ngjarje. (paragrafi i ri)
- OSHMA-të nuk duhet të zbulojnë identitetin e dëshmitarëve, me përjashtim të rastit kur këta persona kanë dhënë më parë pëlqimin e tyre, kur identifikimi i dëshmitarëve ka interes publik, ose kur dëshmia është bërë publike më parë. OSHMA-të nuk zbulojnë identitetin e dëshmitarit kur një gjë e tillë mund të vërë në rrezik jetën ose sigurinë e tij. (paragrafi i ri)
- Gazetarët raportojnë për personat që po kryejnë dënimin me burgim, pa penguar mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë, duke respektuar të drejtat e të dënuarve, privatësinë e personelit të burgut dhe sigurinë e institutit të vuajtjes së dënimit. (paragrafi i ri)
- OSHMA-të tregojnë kujdes në publikimin e pamjeve që dokumentojnë veprimit e ndalimit, shoqërimit ose arrestimit të një personi, me qëllim që të mos cënohet dinjiteti i tij. Pamjet dhe fotot mund të përdoren në mënyrë të ligjshme dhe të përhapen vetëm për të dhënë thelbin e informacionit në lidhje me lajmin që transmetohet. (paragrafi i ri)
- OSHMA-të duhet të tregojnë kujdes në rastet e transmetimit të informacioneve në lidhje me një krim ose aksident, duke kontrolluar paraprakisht dhe me kujdes emrin e viktimës dhe foton e ngjarjes, pa vënë në vëmendje të publikut viktimën dhe të afërmit e saj. (paragrafi i ri)
- OSHMA-të duhet të mbrojnë të dhënat shëndetësore dhe të dhënat e tjera sensitive të personave në të gjitha transmetimet e tyre. Ata duhet të shmangin publikimin e detajeve të panevojshme. (paragrafi i ri)
- Gazetarët nuk duhet të japin të dhëna në lidhje me orientimin seksual, identitetin gjinor ose

karakteristikat e seksit të një personi, pa pëlqimin e tij, ose nëse ato nuk ka lidhje me historinë që tregohet ose qëllimin e programit, si dhe paraqitjen e imazheve "para" dhe "pas" të personave interseks. Gjatë intervistave, gazetari i kërkon personit të shprehet sesi duhet t'i drejtohet. (paragrafi i ri)

- OSHMA-të shmangin publikimin e detajeve identifikuese për personat LGBTI+ si vendi i punës, vendbanimi, shkolla ose të bëjnë përshkrime që në mënyrë të tërthortë e identifikojnë atë.
- OSHMA-lejojnë përdorimin e një pseudonimi, mbulimin e pamjes së një personi ose modifikimin e zërit të tij kur një gjë e tillë kërkohet prej tij, kur diskutohen çështje që kanë të bëjnë me seksualitetin, orientimin seksual, identitetin gjinor ose karakteristikat e seksit.
- OSHMA- ndalohen të përdorimin fotografi ose imazhe të personave LGBTI+ pa lejen e tyre. Nëse ka interes publik, merren masa që paraqitja e imazheve pa lejen e personit të mos e vërë në rrezik atë.
- OSHMA-të bëjnë kujdes gjatë intervistimit të personit LGBTI+ për të mos bërë presion që të tregojë histori të jetës së tij ose të identifikojë familjen e tij.
- OSHMA-të bëjnë kujdes kur pasqyrojnë ngjarje me përfshirjen e një personi LGBTI+ , duke shmangur komente homofobe/transfobe ose të identifikojnë shërbimet mbështetëse, që merr viktimat LGBTI+.
- OSHMA-të respektojnë legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave dhe **udhëzimet** e miratuara nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të zbatueshme në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetareske, letrare ose artistike. Të dhënat e arkivuara në posedim të OSHMA-ve mund të aksesohen, modifikohen ose të fshihen në përputhje me kërkesat ligjore. Megjithatë, OSHMA-të duhet të lejohen të mbajnë të dhëna të tilla për qëllime historike, si pjesë e të dhënave të tyre të transmetimit, dhe për raportimin e çështjeve me interes publik. (paragrafi 3.6)
- Në rastet e ankesave ndaj OSHMA-ve, në lidhje me cenimin e së drejtës së fshehtësisë së jetës private të individit në çdo program të transmetuar, OSHMA- përgjegjëse për ankesën e rastit, është e detyruar të zgjidhë ankesën. Në të kundërt, në rast refuzimi, Këshilli i Ankesave, i shqyrton ato në përputhje me të drejtat dhe detyrimet sipas procedurave të parashikuara në ligjslacionin në fuqi për mediat audiovizive. (paragrafi i ri).

SEKSIONI 3³⁰

TRANSMETIMI I PROGRAMEVE INFORMATIVE

Veprimtaria informative audiovizive, pavarësisht nga profili i operatorit të shërbimit mediatik audioviziv që e ushtron, përbën në të gjitha rastet një shërbim me interes të përgjithshëm publik dhe zhvillohet në zbatim e në përputhje me parimet e kërkesat që vijnë:

- OSHMA-të, gjatë veprimtarisë së tyre informative, duhet të respektojnë dispozitat për lirinë e shprehjes dhe të informacionit në kuadrin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të parashikuara në Kushtetutë, aktet ligjore ndërkombëtare, legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë si dhe standardet e hartuara nga institucionet e organizatat ndërkombëtare që punojnë në këtë fushë **(paragrafi 4.1 i riformuluar)**
- OSHMA-të duhet të ushtrojnë veprimtarinë e tyre informative në përputhje me parimet e parashikuara nga Kushtetuta, **legjislacioni në fuqi dhe të rregullat e parashikuara në këtë Kod (paragrafi 4.2 i riformuluar)**
- Informacioni i transmetuar duhet të jetë i vërtetë, i saktë, i balancuar dhe i verifikuar. **Në rast se konstatohet një pasaktësi në informacionin e transmetuar, një deklaratë jo e vërtetë ose një shtrembërim i një fakti të njohur, OSHMA-të duhet ta korrigjojnë atë menjëherë në të njëjtën formë ofrimi . (paragrafi 4.3 i riformuluar)**
- Informacioni i transmetuar duhet të respektojë pluralizmin, diversitetin e mendimeve dhe formimin e lirë të opinionit. **(paragrafi 4.4 i pandryshuar)**
- Të gjitha lajmet ofrohen në mënyrë objektive dhe të paanshme. **paragrafi 4.5 i pandryshuar)**
- Gazetarët kanë të drejtë të ruajnë sekretin e burimeve të informacionit, me përjashtim të rastit kur gjykata vendos për publikimin e burimit të informacionit. **(paragrafi 4.6 i pandryshuar)**
- OSHMA-të nuk duhet të transmetojnë lajme që cenojnë rregullat e etikës dhe moralit publik, si edhe lajme që mund të nxisin vepra penale, **urrejtje ose qëndrime**, që cenojnë rendin kushtetues, sovranitetin dhe integritetin kombëtar. **(paragrafi 4.7 me një shtesë)**
- Transmetimet audiovizive informative nuk duhet të përmbajnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të nënkuptojnë mesazhe diskriminuese për shkaqe si: gjinia, raca, mosha, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose shoqërore ose për çdo shkak tjetër të parashikuar nga **legjislacioni në fuqi. (paragrafi 4.8 me një shtesë)**
- OSHMA-të, në programet informative, nuk promovojnë për qëllime sensacionale, **në mënyrë direkte ose indirekte dhunën, nuk transmetojnë pamje, thirrje për urrejtje apo mesazhe ekstremiste, nuk**

³⁰ Në kodin e transmetimit në fuqi është seksioni 4.

përdorën gjuhë sensacionale, provokuese ose stigmatizuese veçanërisht kundrejt komuniteteve të veçanta. (paragrafi 4.9 i riformuluar)

- OSHMA-të duhet të jenë të kujdesshme në respektimin e të drejtave të fëmijëve **dhe viktimave të krimit, përfshirë viktimat e krimit në familje**, kur raportojnë rastet, në të cilat fëmijët janë viktimë ose autorë të bulizmit, dhunës seksuale dhe **veprave penale të tjera penale ku fëmijët mund të jenë përfshirë. (paragrafi 4.10 i riformuluar)**
- OSHMA-të nuk lejohet të transmetojnë programe që shfaqin, komunikojnë ose nxisin te fëmijët sjellje të dhunshme, pornografike, pjesëmarrjen e tyre në konflikte etj. **(paragrafi 4.11 i pandryshuar)**
- OSHMA-të nuk duhet të çorientojnë publikun, të keqpërdorin ose të shtrembërojnë deklaratat e bëra në kontekste të caktuara. **(paragrafi 4.12 i pandryshuar)**

OSHMA-të nuk e keqpërdorin në përmbajtje, procedura dhe formë aksesin e tyre në informacion. Informacioni mbledhet në mënyrë etike e ligjore dhe raportohet me kulturë profesionale e gjuhësore, duke shmangur shpërdorimin. **(paragrafi 4.13 i pandryshuar)** OSHMA-të duhet të marrin në konsideratë ndjeshmërinë e publikut në rastet e fatkeqësive, katastrofave, aksidenteve, duke u dhënë përparësi operacioneve të shpëtimit dhe mbështetjes. Media duhet të tregojë maturi me fotot, videot amatore ose pamjet e katastrofave, aksidenteve ose dhunës, duke respektuar ndjenjat e të afërmeve. **(paragrafi 4.14 i ndryshuar)**

- Informacioni i transmetuar nuk duhet të përdoret për përfitime personale ose përfitime të tjera të drejtpërdrejta të pronarëve të mediave audio dhe/ose audiovizive, drejtuesve të tyre dhe gazetarëve. **(paragrafi 4.15 i pandryshuar)**
- OSHMA-të, duhet të shmangin promovimin e padrejtë, gjatë transmetimit të komunikimeve me natyrë tregtare për mallrat si edhe duhet të respektojnë parimin e proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit duke mos favorizuar shoqëri të veçanta tregtare ose subjekte tregtare të lidhura direkt apo indirekt me ortakët apo aksionarët e shoqërive audio dhe/ose audiovizive. **(paragrafi 4.16 i pandryshuar)**
- OSHMA-të kanë detyrimin të publikojnë përgjigjen ose korrigjimin në rast se reputacioni i një personi është prekur drejtpërdrejt nga publikimi i informacionit të pavërtetë faktik ose të pasaktë, por jo për mendimet kritike.³¹ Mendimet kritike nuk mundësojnë të drejtën për t'u përgjigjur.³² **(paragrafi i ri)**
- OSHMA-të duhet të ofrojnë të drejtën e përgjigjes, publike dhe pa pagesë, si formë reagimi ndaj çdo informacioni të publikuar në media, i cili paraqet fakte të pasakta për individin dhe cenon të drejtat e

³¹ Ky parashikim është konsideruar i drejtë dhe në raport me nenin 10 të KEDNJ për lirinë e shprehjes në opinionin e Komisionit të Venecias për Shqiptarët. Për më shumë shih: Opinioni no. 980/2020, dated 19.6.2020 "On draft amendments to laë no. 97/2013 on the audiovisual media service, adopted by the Venice Commission on 19 June 2020, by a written procedure, paragrafi 49. Gjithashtu, rekomandimi Rec (2004)16 i Komitetit të Ministrave mbi të drejtën e përgjigjes në mjedisi i ri mediatik³¹ njeh gjithashtu të drejtën për të reaguar ndaj çdo informacioni në media duke paraqitur fakte të pasakta dhe që prekin të drejtat personale. Për më shumë shih: Recommendation Rec (2004)16 of the Committee of Ministers to member states on the right of reply in the new media environment. Ky rekomandim gjenden në adresën: https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016805db3b6

³² Për më shumë shih: Opinioni no. 980/2020, dated 19.6.2020 "On draft amendments to laë no. 97/2013 on the audiovisual media service, adopted by the Venice Commission on 19 June 2020, by a written procedure, paragrafi 34.

tij/saj personale. E drejta e përgjigjes duhet të aplikohet brenda një kohe mjaft të shkurtër nga publikimi i informacionit të kontestuar. Edhe përgjigjaduhet bërë publike pa vonesa të panevojshme.

(paragraf i ri)

- OSHMA-të duhet t'i japin përgjigjes për aq sa është e mundur, të njëjtën rëndësi që i është dhënë informacionit të kontestuar, në mënyrë që ai të arrijë tek i njëjti publik dhe me të njëjtin ndikim. Kërkesa për përgjigje mund të refuzohet nga nëse gjatësia e përgjigjes tejkalon atë që është e nevojshme për të korrigjuar informacionin e kontestuar; nëse përgjigja nuk kufizohet në korrigjimin e fakteve të kundërshtuara; nëse publikimi do të përbënte një akt të dënueshëm, do ta bënte ofruesin e përmbajtjes përgjegjës ndaj procedurave të së drejtës civile ose do të shkelte standardet e mirësjelljes publike; do të ishte në kundërshtim me interesat e mbrojtura ligjërish të një pale të tretë; prekte ekzistencën e një interesi legjitim; do të ishte në një gjuhë të ndryshme nga ajo në të cilën informacioni i kontestuar është bërë public. ; Informacioni i kontestuar është objekt i një raporti të vërtetë për seancat publike të autoriteteve publike ose gjykatave. **(paragraf i ri)**
- OSHMA-të duhet të mundësojnë ushtrimin efektiv të së drejtës së përgjigjes duke bërë publike emrin dhe detajet e kontaktit të personit të cilit mund t'i drejtohen kërkesat për përgjigje. Nëse informacioni i kontestuar mbahet publikisht i disponueshëm në arkivat elektronike dhe është dhënë e drejta e përgjigjes, OSHMA-të – brenda mundësive - duhet të krijojnë një lidhje ndërmjet të dyjave, në mënyrë që të tërhiqet vëmendja e përdoruesit për faktin se informacioni origjinal është objekt i një përgjigjeje.

(paragraf i ri)

SEKSIONI 4 ³³

FËMIJËT NË TRANSMETIMET AUDIOVIZIVE

Parimet themelore për mediat në shërbim të interesit më të lartë të fëmijës³⁴

- Transmetimet audiovizive për fëmijët dhe Korrekturë ndaj fëmijëve udhëhiqen nga interesi më i lartë i fëmijës. Interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata parësore në çdo veprim të OSHMA-ve që ka të bëjë me fëmijën. **(paragraf i ri)**
- OSHMA-të promovojnë mirëqënien dhe interesin më të lartë të fëmijës pa diskriminim. Fëmijët trajtohen pa asnjë dallim, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare, orientimi seksual, identiteti gjinor, ose çdo gjendje tjetër e fëmijës, prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë. **(paragraf i ri)**
- OSHMA-të respektojnë dhe mbrojnë dinjitetin, nderin dhe personalitetin e fëmijës në të gjithë veprimtarinë e tyre. Fëmija mbrohet nga të gjitha format e diskriminimit, për shkak të pozitës, veprimtarive, opinioneve të shprehura ose bindjeve të prindërve të tij, përfaqësuesve të tij ligjorë ose anëtarëve të familjes së tij. **(paragraf i ri)**
- OSHMA-të garantojnë respektimin e jetës private, familjare, banesës, korrespondencës së fëmijës. Privatësia e fëmijës mbrohet në të gjitha situatat, me përjashtim të rasteve kur interesi më të lartë i fëmijës lejon ndërhyrjen në të dhe në atë masë që është e nevojshme për të përmbushur interesin e fëmijës. **(paragraf i ri)**
- OSHMA-të informojnë në lidhje me mirëqënien, edukimin dhe zhvillimin fizik dhe psikologjik të fëmijës, në një gjuhë miqësore dhe të përshtatshme për të si edhe duke mbajtur parasysh nevojat e tij. OSHMA-të kujdesen për gjuhën dhe përmbajtjen e informimit për fëmijët që kanë nevoja të veçanta, bazuar në nevojat e tyre specifike. OSHMA-të marrin masa të veçanta për t'u mundësuar akses fëmijëve me aftësi të kufizuar në programet e transmetive audiovizive dhe programe për fëmijët që i përkasin pakicave kombëtare. **(paragraf i ri)**
- OSHMA-të mundësojnë dhe respektojnë të drejtën e pjesëmarrjes, dëgjimit dhe përfilljes të mendimit të fëmijës në përputhje me moshën dhe aftësinë e saj për të kuptuar në programet për fëmijë ose përcështje me interes për fëmijën. **(paragraf i ri)**
- OSHMA-të respektojnë lirinë e fëmijës për të shprehur lirisht, individualisht dhe kolektivisht pikëpamjet dhe mendimin e tij për çdo çështje që ka të bëjë me të drejtpërsëdrejti, me familjen e tij ose komunitetin duke respektuar moshën dhe aftësinë e saj për të kuptuar, lirinë e ndërgjegjes dhe besimit në të gjitha transmetimet audiovizive. **(paragraf i ri)**
- OSHMA-të duhet të mbrojnë fëmijën nga aksesit në materiale me përmbajtje të dëmshme ose të paligjshme në programet audiovizive. **(paragraf i ri)**

³³ Në Kodin e Transmetimit në fuqi është seksioni 5.

³⁴ Trajtimi i fëmijëve në media është trajtuar në manualin për gazetarët "Media dhe fëmijët". Disa parime dhe rregulla bazë janë përfshirë në këtë seksion. Gjithashtu, parimet e trajtuara shkurt në fillim të seksionit në fuqi janë zhvilluar.

Media në shërbim të interesit më të lartë të fëmijës

- **(paragraf i ri)**
- OSHMA-të mbështesin transmetimin në media të materialeve që përcjellin shembuj pozitivë të fëmijëve dhe për fëmijët. Ato bëjnë kujdes, të mos promovojnë direkt apo tërthorazi shembuj që ndikojnë negativisht edukimin e fëmijës. **(paragraf i ri)**
-
- OSHMA-të krijojnë mundësi për të shtuar programet për fëmijët dhe përmirësuar cilësinë e tyre si dhe ofrojnë hapësirën e duhur dhe të përshtatshme për moshën, që fëmijët të mund të shprehin lirisht mendimin e tyre. **(paragrafi i ri)**³⁵
- OSHMA-të planifikojnë programe dhe rubrika për fëmijët, të përgatitura edhe nga vetë fëmijët ose në bashkëpunim me ta. **(paragraf i ri)**
- Pjesëmarrja e fëmijës nën moshën 14 vjeç në debate publike si dhe në programe audiovizive bëhet vetëm me pëlqimin me shkrim të prindit ose kujdestarit të fëmijës. Drejtorët e programacionit duhet informojnë prindin ose kujdestarin e fëmijës për qëllimet e programeve dhe qëllimet e angazhimit të fëmijës si edhe duhet të administrojnë në formë shkresore kërkesën për angazhimin e fëmijës dhe miratimin e prindit³⁶. **(paragraf i ri)**
- OSHMA-të mundësojnë pjesëmarrjen e psikologut në të gjitha programet audiovizive ku marrin pjesë dhe pyeten fëmijë nën moshën 10 vjeç. **(paragraf i ri)**
- OSHMA-të duhet të parashikojnë rregulla specifike në Kodin e Sjelljes lidhur adresimin e problemeve të fëmijëve, të fëmijëve-viktima të dhunës, abuzimit fizik, psikologjik, seksual, të trafikimit si dhe standarde të detajuara të trajtimit të fëmijës, me synimmbrojtjen e të drejtave të tij gjatë trasmetimeve audiovizive. **(paragraf i ri)**
- OSHMA-të nuk lejojnë që fëmijët të përdoren ose të ekspozohen nga prindi, kujdestari, institucionet publike ose private për qëllime të përfitimit personal ose për të ndikuar vendimet e autoriteteve publike³⁷. **(paragraf i ri)**
- OSHMA-të marrin masa për të mbrojtur privatësinë dhe të dhënat vetjake të fëmijës në të gjitha trasmetimet audiovizive. Privatësia e fëmijës që merr pjesë në të gjitha fazat e procedurave gjyqësore ose administrative respektohet nga media në transmetimet audiovizive të këtyre procedurave. Rastet përjashtimore nga kufizimi i mbrojtjes së privatësisë ka vetëm nëse ato u shërbejnë interesit më të lartë të fëmijës dhe vetëm në atë masë që u shërbejnë këtij interesi . **(paragraf i ri)**
- OSHMA-të krijojnë mundësitë për realizimin e emisioneve apo programeve si dhe botimin e rubrikave për fëmijë në gjuhët e minoriteteve etnike dhe kulturore që jetojnë në Shqipëri. **(paragraf i ri)**

³⁵ Do të ishte e rekomandueshme që në KT të rregullohet planifikimi i duhur i programeve në shqip për fëmijët. Fjala është natyra dhe përmbajtja e programit, numri i mundshëm i fëmijëve që mund ta ndjekin, dita, ora, kohën e fillimit dhe mbarimit të programit, kanalin në të cilin do të transmetohet program për fëmijët. Kjo do t'i mundësonte Këshillit të Ankesave që të monitoronte programet e ofruara nga OSHMA.

³⁶ Sugjerimi buron nga kërkesat e nenit 17 & 8 të ligjit 37/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

³⁷ Sugjerimi buron nga kërkesat e nenit 17 & 5 të ligjit 37/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

- OSHMA-të nxiten të kryejë fushata informuese dhe ndërgjegjësuere për fenomenin e shfrytëzimit dhe të abuzimit seksual të fëmijëve dhe për masat parandaluese që duhet të merren në këtë kuadër. **(paragraf i ri)**
- OSHMA-të inkurajohen të ofrojnë informacion të nevojshëm lidhur me fenomenin e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual të fëmijëve dhe mënyrat e parandalimit të tij, duke respektuar të drejtat e fëmijës dhe interesin më të lartë të saj. **(paragraf i ri)**
- OSHMA-të nuk transmetojnë programe të dëmshme për fëmijët midis orës 6:00 dhe orës 22:00. **(paragraf i ri)**
- OSHMA-të, në çdo rast, sigurojnë marrjen e masave për ndalimin e publikimeve me përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme për fëmijët. Në rast të vënies në dijeni për transmetimin e një materiali me përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme, ata marrin masa për fshirjen ose bllokimin e tij.³⁸ **(paragraf i ri)**
- OOSHMA-të që përmbajtjen e tyre e publikojnë në faqet online, shqyrtojnë pa vonesë dhe me përparësi çdo raportim nga të tretë ose çdo rast të konstatuar gjatë veprimtarisë së vet lidhur me faqe/materiale me përmbajtje potencialisht të paligjshme dhe/ose të dëmshme për fëmijët në internet dhe marrin masat për fshirjen ose bllokimin e tyre. **(paragraf i ri)**.
- Këshilli i Ankesave shqyrton me përparësi çdo raportim nga të tretë ose çdo rast të konstatuar gjatë veprimtarisë së vet lidhur transpozimin e prodhimeve me përmbajtje potencialisht të paligjshme dhe/ose të dëmshme për fëmijët në faqet zyrtare të OSHMA-ve, të publikuara online dhe kërkon fshirjen ose bllokimin e tyre nga ofruesit e shërbimeve mediatike. **(paragraf i ri)**

Ndalimi i identifikimit të fëmijës³⁹

- OSHMA-ve u ndalohet raportimi transmetimi ose **shpërndarja e çdo të dhëne** që çon direkt ose indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, adresë ose përshkrim të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar ose i deklaruar fajtor për kryerjen e një vepre penale, përveç rasteve kurka **interesi të ligjshëm publik dhe për aq sa publikimi i shërben këtij interesi dhe interesit më të lartë të fëmijës⁴⁰**. **paragrafi 5.1 i riformuluar)**
- OSHMA-të **shmangin çdo raportim, transmetim ose shpërndarje të çdo të dhëne** që çon direkt ose indirekt në identifikimin e çdo fëmije në një **ngjarje familjare ose në mjedise të tjera**. Ndalohet

³⁸ Vendim Nr. 465, date 3.7.2019 “Për masat për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesit në përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme në internet. Ky vendim ka dalë në zbatim të ligjit 37/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”. AMA ka detyrimin të marrë masa për bllokimin e përmbajtjeve të tilla.

³⁹ Në kodin e transmetimit në fuqi, nënseksioni është emërtuar “Identifikimi i fëmijës”.

⁴⁰ Ky detyrim buron nga rekomandimi “Guidelines of the Committee of Ministers of the Council of Europe on child-friendly justice: paragrafi 57-61.

intervistimi i fëmijës, për shkak të përkatësisë së saj në këto kategori: si fëmijë larguar nga familja, fëmijë e aksidentuar, **fëmijë që ka tentuar të vrasë veten, si viktimë e shfrytëzimit ose përdorimit nga grupe kriminale, fëmijë e përfshirë në prostitucion, ose veprimtari të tjera të shfrytëzimit seksual, fëmijë me prindër të arrestuar ose të dënuar, fëmijë-dëshmitarë të dhunës në familje ose shoqëri. (paragrafi 5.2 i riformuluar)**

- Në rastet e parashikuara në pikat 4.1 dhe 4.2 ⁴¹më sipër, **OSHMA-të duhet të përdorin** teknologji të përshtatshme mbulimi, e cila mundëson fshehjen e identitetit me pamje dhe zë të fëmijës dhe të shmangin pamjet që mundësojnë identifikimin direkt ose indirekt të fëmijës. **(paragrafi 5.3 i riformuluar)**
- **OSHMA- të duhet të shmangin publikimin e të dhënave, përfshirë edhe fotot ose pamjet e fëmijëve në media**, përfshirë: identifikimin dhe inicialet e fëmijës; identitetin e prindërve, ose të çdo të afërmi që bën të mundur identifikimin e tërthortë të fëmijës; rrethana apo detaje mbi ngjarjen, që bëjnë të mundur identifikimin e fëmijës, cenojnë dinjitetin e tij dhe nuk i shërbejnë interesit legjitim publik; të dhëna për shkollën, kopshtin, institucionin; të dhëna për **emërtimin e rrugës, numrin e banesës apo pamje të banesës ku banon fëmija**, emrin e autorit të krimit, kur ai ka marrëdhënie familjare me fëmijën -viktimë. **(paragrafi 5.4 i riformuluar)**
- **OSHMA –të duhet të shmangin fokusimin** ose fotografimin e palëve të treta jo-fëmijë, kur kjo mund të çojë në identifikimin direkt ose indirekt të fëmijës, sipas pikave 4.1 dhe 4.2 ⁴²të sipërpërmendura. **(paragrafi 5.5 i riformuluar)**
- Pamjet ose imazhet e fëmijëve ndalohet të merren në mënyrë të fshehtë **dhe të transmetohen**. Ato merren në mënyrë të ndershme **dhe përdoren vetëm për qëllimin e shpjeguar**. OSHMA-të mund të marrin pamje ose imazhe të fëmijës **vetëm me dijeninë dhe pëlqimin e fëmijës dhe të prindërve të tij ose kujdestarit ligjor të fëmijës**, pasi t'u jetë shpjeguar qëllimi dhe mënyra e përdorimit të tyre, **Nëse fëmija nuk pranon, pëlqimi i prindit ose kujdestarit të tij nuk mjafton. Ndalohet marrja dhe transmetimi i pamjeve degraduese dhe poshtëruese të fëmijës, që dëmtojnë dinjitetin e tij, edhe nëse prindi ose kujdestari i tij japin pëlqim me shkrim. (paragrafi 5.6 i riformuluar)**
- **OSHMA-të shmangin çdo transmetim të pamjeve degraduese ose poshtëruese të fëmijës për çfarëdolloj qëllimi**. OSHMA-ve u ndalohet transmetimi i pamjeve të fëmijëve me nuancë seksuale ose paraqitja e fëmijës në pozicione të papërshtatshme; ato shmangin transmetimin e situatave dhe mjedisëve denigruese, kur fëmija është i identifikueshëm **në mënyrë direkte ose indirekte. (paragrafi 5.7 i riformuluar)**
- **OSHMA-të, gjatë publikimit të ngjarjeve, raportimit për të drejtat e fëmijëve në konflikt me ligjin, marrjes së informacionit lidhur me kushtet në institucionet ku mbahen të miturit në konflikt me**

⁴¹ Referenca do të rregullohet pas numërtimit të paragrafëve.

⁴² Idem.

ligjin, duhet të respektojnë detyrimisht privatësinë dhe të drejtat e tjera të të miturve të dënuar⁴³.
(paragraf i ri)

- OSHMA-të, gjatë raportimit të ngjarjeve ose transmetimit të informacioneve nuk çenojnë të drejtën për privatësi si edhe mbrojtjen e fëmijës dhe familjes së saj, përfshirë mbrojtjen e të dhënave personale në çdo raportim për ngjarjen, ku përfshihen prindërit ose pjesëtarë të rritur të familjes së fëmijës, që duhet të jetë në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës. (paragraf i ri)
- OSHMA-të shmangin stereotipet negative dhe stigmatizimin kundrejt fëmijës me prindër të dënuar.⁴⁴(paragraf i ri)
- OSHMA-të miratojnë dhe zbatojnë rregulla të qarta dhe të detajuara për mbledhjen, përpunimin, arkivimin, përdorimin dhe shpërndarjen e materialeve dhe filmimeve me fëmijë, duke parandaluar dhe ndaluar mundësitë e keqpërdorimit të tyre. (paragrafi 5.9 i riformuar).

Intervistimi i fëmijës

- OMSHA-të nuk mund të intervistojnë fëmijë nën moshën 10 vjeç. Intervistimi i fëmijës mbi moshën 10 vjeç kryhet në prani të prindit ose përfaqësuesit ligjor si edhe me pëlqimin e vetë fëmijës. (paragrafi 5.10 i riformuar)
- Para intervistimit, fëmijës dhe përfaqësuesit ligjor duhet t'i shpjegohet paraprakisht qëllimi i intervistë dhe kufizimi i sferës së përdorimit të saj vetëm për qëllimin e shpjeguar. Në çdo rast duhet të respektohet e drejta e fëmijës dhe përfaqësuesit ligjor për të refuzuar. Nëse fëmija nuk pranon të intervistohet, pavarësisht pëlqimit të përfaqësuesit ligjor, intervista nuk kryhet. (paragrafi 5.11 i riformuar)
- Në rast se përfaqësuesi ligjor refuzon intervistimin e fëmijës, intervista mund të kryhet vetëm nëse fëmija mbi moshën 10 vjeç këmbëngul të intervistohet dhe intervistimi është në interesin më të lartë të fëmijës. Në këtë rast, gazetari mund ta realizojë intervistën me fëmijën vetëm në prani të psikologut, punonjësit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, mësuesit të shkollës ose edukatorit. (paragrafi 5.12 i riformuar)
- Ndalohet çdo premtim, dhënie dhurate ose ushtrimi i presionit fëmijës ose përfaqësuesit të tij ligjor me qëllim mundësimin e intervistimit. (paragrafi 5.13 i riformuar)
- Nëse është e nevojshme, gjatë intervistimit të fëmijës, krahas përfaqësuesit ligjor, gazetari mund të kërkojë asistencën e një psikologu ose punonjësi social të specializuar. Gazetari që interviston fëmijën duhet të jetë i trajnuar për metodat e intervistimit të fëmijës. (paragrafi 5.14 i riformuar)

⁴³ Ky detyrim buron nga Rekomandimi CM/Rec (2008)11 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për Rregullat Evropiane për të dyshuarit/të dënuarit e mitur që u nënshtrohen sanksioneve dhe masave.

⁴⁴ Ky detyrim buron nga rekomandimi "Recommendation CM/Rec(2018)5 of the Committee of Ministers to member States concerning children of imprisoned parents".

- Intervistimi i fëmijës zhvillohet në një mjedis të përshtatshëm dhe **miqësor për fëmijën**. Intervistimet dhe filmimet që lodhin dhe ndikojnë negativisht te fëmija si dhe përsëritja pa arësye e intervistimit dhe filmimit të të njëjtit fëmijë duhen të shmangen. **(paragrafi 5.15 i riformuluar)**
- Pyetjet e drejtuara fëmijës duhet të jenë të qarta, të drejtpërdrejta dhe të mos i sugjerojnë fëmijës përgjigjen. **(paragrafi 5.16 i pandryshuar)**
- Gjatë intervistimit, duhet të shmangen pyetjet ose komentet paragjyquese, që dëmtojnë fëmijën ose që i sjellin ndërmend ngjarjen e ndodhur. Nëse gjatë intervistimit, fëmija nuk ndihet mirë, intervistimi ndërpritet menjëherë. **(paragrafi 5.17 i riformuluar)**
- Nëse gjatë intervistimit, gazetari vihet në dijeni për një vepër penale të kryer ndaj fëmijës ose që e rrezikon atë, gazetari vetë dhe OSHMA-ja njoftojnë menjëherë organet përkatëse. **(paragrafi 5.18 i pandryshuar)**
- Në rast se gjatë intervistimit, gazetari vihet në dijeni për fakte, publikimi i të cilave mund të rrezikojnë jetën, shëndetin, mirëqenien fizike, emocionale, morale dhe arsimimin e fëmijës, intervista ose pjesë të saj nuk transmetohen. **(paragrafi 5.19, i pandryshuar)**
- OSHMA-të shmangin intervistimin dhe transmetimin e intervistave me fëmijë, viktime të abuzimit seksual dhe të formave të tjera të abuzimit, përveç rastit kur transmetimi i intervistës është në interes të fëmijës dhe njëkohësisht ka interes të ligjshëm publik. Në rastin e transmetimit, fytyra, të dhënat dhe rrethanat e tjera që mund të identifikojnë fëmijën, përfshirë inicialet e emrit dhe të mbiemrit nuk zbulohen. **(paragrafi 5.20 i riformuluar)**

Reklamat dhe fëmijët

- OSHMA –të transmetojnë spote sensibilizuese në dobi të fëmijëve , me synim nxitjen e ushqyerjes dhe jetesës së shëndetshme, pjesëmarrjen e fëmijës në diskutimin e problemeve me interes për ta në fushën e arsimimit, kujdesit shëndetësor, edukimit, mjedisit, inovacionit, mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, mënyrave të adresimit të keqtrajtimit, abuzimit, shfrytëzimit dhe parandalimit të rreziqeve për fëmijët. **(paragraf i ri)**
- OSHMA-të duhet të mbështesin, mbrojnë dhe promovojnë të ushqyerit me gji. **(paragraf i ri)**
- OSHMA-të ndalohen të reklamojnë me çfarëdoq mjeti nxitjen, shitjen ose konsumin e prodhimeve zëvendësuese të qumështit të gjirit. **(paragraf i ri)**
- OSHMA-të ndalohet të reklamojnë apo promovojnë produkte qumështi ose të ngjashme me qumështin, , përgatitur industrialisht për t’u tregtuar për ushqimin e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël si dhe çdo produkt tjetër industrial, që tragtohet për ushqimin e tyre. **(paragraf i ri)**
- Reklamat për fëmijët duhet të përmbajnë gjuhë miqësore për fëmijët dhe të përshtaten me nevojat e grupit të fëmijëve të cilëve u drejtohet reklama. **(paragrafi 5.29 i riformuluar)**

- OSHMA-të nuk duhet të transmetojnë reklama që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve. OSHMA-të nuk duhet të transmetojnë reklama të shërbimeve dhe produkteve, që paraqesin rrezik për zhvillimin fizik, mendor dhe moral të fëmijëve. (paragrafi 5.21)
- OSHMA- ve u ndalohet transmetimi i reklamave për pijet alkoolike, pijet energjike dhe pijet e gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar në brendësi të një programi drejtuar fëmijëve si dhe 60 minuta para dhe pas këtij programi. (paragrafi 5.22)
- OSHMA-të nuk duhet të transmetojnë asnjë formë reklame të pijeve alkoolike, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar, të cilat u drejtohen të miturve ose ku të miturit janë pjesëmarrës. Produktet e ndaluara për reklamim janë të përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi.
- OSHMA- të nuk kryejnë vendosje produkti në programet për fëmijë. (paragrafi ri)
- (paragraf i ri)
- OSHMA-të nuk transmetojnë reklama, që u drejtohen fëmijëve për të nxitur drejtpërdrejt blerjen e mallrave ose shërbimeve ose/dhe për të bindur prindërit apo persona të tjerë të rritur të blejnë këto mallra apo shërbime. (paragraf i ri)

OSHMA-të kontrollojnë paraprakisht përmbajtjen e reklamave, promocionit të programeve dhe veçanërisht të reklamave me dhe për fëmijët, duke garantuar që çdo fëmijë ose imazh fëmije, i përdorur në reklama, të jetë i shoqëruar me lejen me shkrim të prindit ose përfaqësuesit ligjor të fëmijës. Për fëmijët e moshës mbi 14 vjeç merret edhe pëlqimi me shkrim i fëmijës. (paragrafi 5.23, i riformuluar)

- ⁴⁵

OSHMA-të hartojnë dhe zbatojnë kode sjelljeje lidhur me komunikimet e papërshtatshme me natyrë tregtare, që shoqërojnë ose përfshihen në programet për të mitur, për ushqimet dhe pijet, që përmbajnë substanca të dëmshme ose të padobishme për shëndetin fizik të të miturve, si yndyrë, acide yndyrore, kripë, sodë apo sheqer, që kapërcejnë normat e lejuara për një dietë ushqimore të shëndetshme për këtë moshë.

- OSHMA-të hartojnë rregulla të brendshme për formatin e dhënies se lejes me shkrim të prindit ose

⁴⁵ AMA mund t'i referohet listës së produkteve të pashëndetshme dhe të ndaluara për reklamim në mjediset arsimore të arsimit bazë. Produktet të ndaluara për tu reklamuar dhe konsumuar në mjediset e institucioneve arsimore bazë janë përcaktuar në urdhërin e përbashkët të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë për miratimin e rregullores "Për ndalimin e reklamimit të ushqimeve të pashëndetshme në mjediset e institucioneve arsimore të arsimit bazë" Këto produkte janë: ëmbëlsira (çokollatë dhe produkte çokollate ose të veshura me çokollatë' ëmbëlsirat, kos ose fruta të thata dhe arra të veshura me sheqer; bareta drithërash, ëmbëlsira me fruta të përpunuara; ushqime të skuqura, përfshirë produktet e skuqura thellë në procesin e prodhimit (patatina, salsiçe të skuqura, kofshë pule të skuqura, petulla etj; ushqime të aromatizuara me përmbajtje yndyre, yndyre të ngopur, natriumi dhe sheqeri; pije freskuese me ose pa gaz; pije të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar; lëngjet e frutave të ëmbëltuara me sheqer të shtuar; lëngjet e perimeve me sheqer ose kripë të shtuar; lëngje të ëmbla të koncentruara, të bëra ose të aromatizuara me lëngje frutash, të cilat hollohen për të bërë një pije; qumësht i plotë; pijet energjike.

kujdestarit të fëmijës në rastin e përfshirjes së fëmijëve në reklama. (paragraf i ri)⁴⁶

- Reklamata nuk duhet të paraqesin fëmijë, ose të rritur në prani të fëmijëve duke konsumuar pije alkoolike, produkte të ndryshme të duhanit, përfshirë cigaret elektrike dhe shishat, pije energjike, ose pije të gazuara me sheqer të shtuar, produkte ushqimore ose substanca të tjera të dëmshme për fëmijët. (paragrafi 5.26 i riformuluar).
- Transmetimi i programeve për të miturit mund të ndërpritet nga spote reklamash ose shitjesh të drejtpërdrejta jo më shpesh se çdo 30 minuta, nëse kohëzgjatja e programit është më shumë se 30 minuta (paragraf i ri).
- Shërbimet e transmetimit audioviziv për fëmijë nuk mund të sponsorizohen nga shoqëri, persona ose sipërmarrje, veprimtaria kryesore e të cilave është prodhimi ose tregtimi i cigareve ose prodhimeve të tjera të duhanit. (paragraf i ri)
- Gjatë transmetimit të programeve për të mitur ndalohet shfaqja e shenjave të sponsorizimit. (paragraf i ri)
- Reklamimi i një shërbimi ose produkti nuk lejohet të krijojë perceptimin se mungesa e tij do ta vendosë fëmijën në pozita inferiore ose diskriminuese në raport me të tjerët (paragrafi 5.28 i riformuluar).
- Ndalohet reklama në median e shkruar, elektronike dhe audiovizive për lojëra fati në një mënyrë që shfaqet veçanërisht për të miturit ose që i paraqet lojërat e fatit si zgjidhje të problemeve financiare. (paragraf i ri).
-
- OSHMA-të nuk duhet të transmetojnë në programet audiovizive për fëmijë materialet promocionale lidhur me lojërat e fatit si dhe reklama që ofrojnë, ndihmojnë ose nxisin lojërat e fatit. (paragraf i ri)
- Reklamata audiovizive për bastet sportive gjatë transmetimit të aktiviteteve sportive kombëtare dhe ndërkombëtare janë të ndaluara (paragraf i ri).

Programet kulturore, argëtuese, edukuese, filmat dhe fëmijët

- OSHMA-të nuk transmetojnë programe që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve, në veçanti filma ose programe që përmbajnë pornografi ose/dhe skena dhune të skajshme. (i pandryshuar paragrafi 5.30)
- ⁴⁷ (Riformuluar paragrafi 5.31)

⁴⁶ Sugjerohet të shtohet një paragraf i që i kërkon OSHMA të vetrregullohen duke hartuar rregulla të brendshme për formatin e dhënies se lejes me shkrim të prindit ose kujdestarit të fëmijës. Do të ishte e rekomandueshme që për këtë vetrregullim të parashikohej një afat dhe detyrimi që OSHMA të njoftojnë AMA-n për përmbushjen e këtij detyrimi. Praktikata e mira që mund të jenë në zbatim nga media të ndryshme inkurajohen të ndahen me ofruesit e tjerë të shërbimeve.

⁴⁷ Ky problem është adresuar në mënyrë të veçantë nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

- OSHMA-të kujdesen të mos lëndojnë ndjeshmëritë e publikut **me standardin e etikës së komunikimit**, përfshirë komunikimin e dhunshëm dhe seksist apo paraqitjen provokuese të drejtuesve dhe pjesëmarrësve të programeve muzikore, kulturore, argëtuese dhe edukuese për shkak të modelit, që ata ofrojnë për publikun dhe efektin e tyre në zhvillimin moral, mendor e fizik të fëmijëve.
 - OSHMA planifikojnë orare të përshtatshme për programe edukimi, kulturore dhe argëtuese për fëmijët dhe me fëmijët. OSHMA inkurajohen të planifikojnë më shumë programe edukimi me fëmijët, duke inkurajuar modelet positive të fëmijëve. (Riformuluar paragrafi 5.32)
 - OSHMA-të duhet të zbatojnë me përpikëri kërkesat etike-morale dhe të mbrojnë të drejtat e fëmijëve në programet edukuese, kulturore argëtuese për fëmijë dhe me fëmijët. Përmbajtja e programeve të tilla vlerësohet nga Këshilli i Etikës që funksion pranë OSHMA-së.⁴⁸ (Riformuluar paragrafi 5.33)
 - OSHMA-të duhet të zgjedhin orarin e transmetimit të programeve që mund të dëmtojnë zhvillimin mendor, fizik ose moral të fëmijëve. Këto programe transmetohen në fashën kohore 23.00 - 06.00. (Paragrafi 5.34, i reformuluar).
 - Kur programe me përmbajtje të papërshtatshme për fëmijët transmetohen në formë të hapur ato duhet të paraprihen nga një paralajmërim akustik ose të identifikohen nga prania e një simboli viziv gjatë gjithë kohëzgjatjes së tyre. (paragrafi 5.35, i pandryshuar)
- OSHMA-të duhet të mbajnë parasysh dëmin që mund të shkaktohet nga transmetimi i materialeve të papërshtatshme për fëmijët, në programet për fëmijë, për të rritur dhe në programet e një natyre të veçantë, si psh. **programet investigative, programet e bamirësisë, ndërmjetësimit ose programet që adresojnë familje në nevojë, përfshirë fëmijët dhe/ose prindërit e tyre.**
- Në përgatitjen dhe transmetimin e programeve, OSHMA-të marrin masa për të mbrojtur dinjitetin e fëmijës nga diskriminimi për shkak të gjendjes shëndetësore, pozitës ekonomike dhe sociale të familjes, predispozitave gjenetike, statusit social, etj. (Paragraf i ri)
 - OSHMA-të duhet të mbajnë parasysh interesat e edukimit të fëmijës ndaj transmetimeve audiovizive në sasi e cilësi për të shmangur rrezikun e varësisë së fëmijës ndaj televizionit dhe shndërrimin e personazheve televizive në model imitimi për ta (paragrafi 5.37, i pandryshuar)
 - OSHMA-të duhet të trajtojnë me respekt, dinjitet e profesionalizëm të gjithë fëmijët që marrin pjesë në programet audiovizive. (paragrafi 5.38, i pandryshuar)

⁴⁸ Sugjerohet që emisionet për fëmijët të kenë një këshill etik që duhet të sigurojë që nuk çënohen çështjet etike për fëmijët pjesëmarrës. Sugjeruar nga Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

- OSHMA-të nuk duhet të lejojnë, në programet e tyre, përdorimin e fëmijëve me probleme patologjike ose me aftësi të kufizuara për qëllime propagandistike, pëfitimi apo për çdo qëllim tjetër abuziv kundrejt të drejtave dhe dinjitetit të tyre. (paragrafi 5.39, i pandryshuar)
- OSHMA-të janë të detyruara të vendosin shenjat paralajmëruese për mbrojtjen e fëmijëve, në çdo transmetim, **që përmban skena të papërshtatshme për fëmijën.** (paragrafi 5.40, i riformuluar)
- OSHMA-të duhet të tregojnë kujdes të veçantë për gjuhën dhe komunikimin etik në programet edukuese, argëtuese, të humorit, në spektaklet e organizuara me dhe për fëmijët duke ndaluar veçanërisht bulizmin dhe/ose stigmatizimin e fëmijës për shkaqe të ndryshme”. (riformuluar paragrafi 5.41)⁴⁹
- OSHMA-të, në rastin e Shërbimeve Mediatike Audiovizive në bazë të kërkesës (on demand), duhet të transmetojnë në formë të koduar programet që mund të dëmtojnë rëndë zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve. OSHMA duhet të mos transmetojë programe pornografike pa siguruar mbrojtjen e fëmijëve, nëpërmjet pajisjeve të aksesit të kushtëzuar dhe kontrollit prindëror. (paragrafi 5.42 i pandryshuar)
- **OSHMA-të shmangin transmetimet me përmbajtje dhune, bullizmi, gjuhë urrejtje, fjalor banal dhe të papërshtatshme, të pakontrolluara dhe të dëmshme për fëmijët, përfshirë këngë dhe/ose video në oraret e arritshme nga fëmijët.**
- Në transmetimet e filmave, OSHMA-të duhet të zbatojnë kërkesat e ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996 “Për Kinematografinë”, i ndryshuar. (paragrafi 5.43, i pandryshuar).

Shenjat paralajmëruese për mbrojtjen e fëmijëve në programet audiovizive⁵⁰

- OSHMA-të detyrimisht përdorin shenja paralajmëruese për programet që transmetohen në fashën orare 19.00 – 22.00 dhe që mund të cenojnë ose dëmtojnë fëmijët. (paragrafi 5.44 i riformuluar)
- OSHMA-të duhet të transmetojnë programet e përcaktuara në **pikën 5.44⁵¹ më sipër**, me shenjën përkatëse, e cila duhet të shfaqet në ekran, në një vend të dukshëm, me ngjyrë të qartë e të dallueshme. (Paragrafi 5.45 i saktësuar)
- OSHMA-të duhet të përgatisin transmetimin e filmave ose programeve të përcaktuara **në pikën 5.44** me shenjën përkatëse (kur programi vetë nuk e përcakton), duke u mbështetur në vizionimin paraprak të programit, sipas kriterëve, standardeve e rregullave të Kodit të Transmetimit. (Paragrafi 5.46 i saktësuar)

⁴⁹ Trajtimi me dinjitet dhe etika e komunikimit me fëmijët në programet me dhe për fëmijët është një shqetësim i adresuar gjatë takimeve. Emisionet e humorit në skeçe të veçanta shpesh imitojnë ose perqeshin gjuhën ose sjellje të fëmijëve, duke bullizuar apo stigmatizuar fëmijët. Shumica e të intervistuarve e kanë adresuar këtë shqetësim.

⁵⁰ Është e rekomandueshme që paragrafët e këtij nënseksioni të riformulohen nga pikëpamja e teknikës legislative Numërtimi i paragrafëve mund të ndryshojë në variantin integral të projektit të Kodit të Transmetimit.

⁵¹ Numërtimi do të saktësohet në variantin përfundimtar të projektit të Kodit të Transmetimit.

- Shfaqja e shenjës paralajmëruese në ekran bëhet menjëherë me fillimin e programit ose filmit dhe e shoqëron atë gjatë gjithë kohës së transmetimit. Shenja paralajmëruese rishfaqet para dhe pas të gjitha ndërprerjeve të programit në vijim, deri në përfundim të tij. (paragrafi 5.47 i pandryshuar).
- Llojet e shenjave paralajmëruese, që **duhet** të përdoren nga OSHMA-të do të jenë tre:
 - i. Shenjë paralajmëruese me *ngjyrë të kuqe*, për përmbajtje që transmetohen vetëm pas orës 22.00, me skena të rënda dhune psikologjike e fizike, seksuale, me keqpërdorim të gjuhës, fjalorit dhe etikës së komunikimit.
 - ii. Shenjë paralajmëruese me *ngjyrë portokalli* për përmbajtje, të cilat fëmijët duhet t'i ndjekin të shoqëruar nga të rriturit.
 - iii. Shenjë paralajmëruese me *ngjyrë të gjelbër*, për përmbajtje që mund të ndiqen nga të gjithë, përfshirë edhe fëmijët. (paragrafi 5.48 i pandryshuar)
- OSHMA-të mund të përdorin forma të ndryshme të zgjidhjes grafike për shenjat paralajmëruese, si për shembull kategorizim grupmoshe, por ngjyra dhe qartësia e shenjës janë elementë të pandryshueshëm dhe të detyrueshëm për të gjithë. (paragrafi 5.49 i pandryshuar)

SEKSIONI 6

RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR DHE AKSESI NË TRASMETIMET AUDIOVIZIVE.⁵²

- OSHMA-të marrin masa që të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara të kenë akses, në baza të barabarta, në përmbajtjen e transmetimeve televizive, shërbimeve, pajisjeve, sistemeve dhe aplikacioneve, të ofruara për publikun, në platformat dhe teknologjinë, përmes të cilave ai ofrohet. (Paragraf i ri)
- OSHMA-të ofrojnë shërbim interpretimi në gjuhën e shenjave; përshkrim me zë të titrave, të transmetimeve në kohën e shikueshmërisë maksimale, veçanërisht të lajmeve dhe veprimtarive apo programeve të tjera me interes për personat me nevoja të veçanta.
- OSHMA-të zhvillojnë praktika që mundësojnë aksesueshmëri në programe specifike video ose audio për personat me një shkallë të caktuar paaftësie dëgjimi ose shikimi. (paragraf i ri)
- OSHMA-të informojnë personat me paaftësi të pjesshme dëgjimi ose shikimi mbi programacionet e aksesueshme për ta dhe mundësojnë udhëzues të programeve të aksesueshme për personat me nevoja të veçanta, përfshirë personat që nuk shikojnë apo dëgjojnë, si edhe ata me shikim dhe dëgjim të kufizuar. (paragraf i ri)
- OSHMA-të bashkëpunojnë me organizatat e personave me aftësisë së kufizuar për të përcaktuar programet, të cilat do të jenë të aksesueshme për ta, si: emisionet informative, informimin për situatat e emergjencës dhe fatkeqësitë natyrore, transmetimet e drejtpërdrejta për zhvillimet me rëndësi në jetën politike, ekonomike dhe sociale të vendit. (paragraf i ri)
- OSHMA-të publike kanë përgjegjësi të bëjnë të aksesueshme më shumë programe për personat me një shkallë të caktuar paaftësie dëgjimi ose shikimi, sesa ato private. (paragraf i ri)
- AMA inkurajon OSHMA-të që të sigurojnë bashkërendimin mes tyre dhe kompanive që ofrojnë pajisje që u mundësojnë përdoruesve me aftësi të kufizuara marrjen, dekodimin, shfaqjen e shërbimeve të aksesueshme. (paragraf i ri)
- **OSHMA-të respektojnë dinjitetin e personave me aftësi të kufizuar dhe japin një imazh të respektuar të personave me aftësi të kufizuar në transmetimet audiovizive. (paragrafi 6.1 i riformuluar).**
- **OSHMA-të kombëtare detyrohen që të përdorin gjuhën e shenjave në të paktën një prej edicioneve kryesore të lajmeve çdo ditë, me qëllim garantimin e të drejtës së informimit për personat me nevoja të veçanta shqisore. (paragrafi 6.1 i riformuluar)**

⁵² Titulli i mëparshëm ishte: Personat me aftësi të kufizuar në transmetimet audiovizive

- OSHMA-të gjatë transmetimeve audiovizive nuk duhet të paragjykojnë, të përdorin ose të identifikojnë persona me aftësi të kufizuara, me qëllim që të mos dëmtojnë interesat dhe të drejtat e tyre. (paragrafi 6.6 i riformuluar)
- OSHMA-të duhet t'i trajtojnë me etikë dhe kujdes maksimal pamjet e personave me aftësi të kufizuara. Aftësitë e kufizuara të tyre nuk duhet të paraqiten me detaje dhe gjuha e komunikimit e gazetarëve duhet të respektojë dinjitetin e tyre. (paragrafi 6.8 i riformuluar)
- OSHMA-⁵³të ndalohen të ofrojnë imazhe dramatike dhe të shtrembëruara të sëmundjeve mendore në programet informative dhe argëtuese, të paraqesin modele që nxisin reagime negative ndaj personave me probleme të shëndetit mendor, përfshirë frikën, refuzimin talljen, ose që promovojnë stigmën dhe diskriminimin ndaj njerëzve me sëmundje mendore. (paragrafi i ri),
- OSHMA-të mbrojnë dhe promovojnë shëndetin mendor, kontribuojnë në informimin për rëndësinë e zbulimit të hershëm të problemeve të shëndetit mendor, me synim parandalimin dhe luftimin e paragjyqimeve publike dhe pranimin shoqëror të tyre, luftojnë diskriminimin dhe stigmën në mjedisin shoqëror si dhe promovojnë modele pozitive njerëzish që jetojnë me sëmundje mendore. (paragrafi i ri)
- OSHMA-të ndalohen të publikojnë të dhëna konfidenciale për shkak të gjendjes shëndetësore të personave me aftësi të kufizuara, përfshirë probleme të shëndetit mendor. (paragrafi i ri)
- OSHMA-të kanë për detyrë të informojnë publikun për të drejtat e personave me nevoja të veçanta, të tërheqin vëmendjen dhe të sensibilizojnë shoqërinë dhe institucionet e ndryshme për përgjegjësinë ndaj personave me aftësi të kufizuara. (paragrafi 6.2 i riformuluar)
- OSHMA-të inkurajohen të bashkëpunojnë për të promovuar përpjekjet e shoqatave dhe personave me aftësi të kufizuara për integrimin e tyre në jetën shoqërore. (paragrafi 6.3 i riformuluar)
- OSHMA-të duhet të sigurojnë trajtim të drejtë dhe objektiv të personave me aftësi të kufizuara në programet e tyre. OSHMA-të vlerësojnë, inkurajojnë dhe promovojnë modelet pozitive të personave me aftësi të kufizuara. (paragrafi 6.4 i riformuluar)
- OSHMA-të nuk duhet të lejojnë përdorimin e imazhit të personave me aftësi të kufizuara për publicitet ose reklama. (paragrafi 6.1 i pandryshuar)
- OSHMA-të nuk duhet të shfrytëzojnë ndjeshmërinë e publikut ndaj personave me aftësi të kufizuara për përfitime ose qëllime komerciale. (paragrafi 6.1 i pandryshuar)

⁵³ Disa parime themelore të përfshira në projektin e Kodit të transmetimit janë bazuar në një material të botuar nga instituti i medias, ligji nr/44/2012 "Për shëndetin mendor", i ndryshuar, dhe strategjia për personat me aftësi të kufizuara. Për më shumë shih: <http://www.institutemedia.org/wp-content/uploads/2020/06/Etika-e-medias-siguria-dhe-shendeti-mendor-converted.pdf>; https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/Ligji_Nr.44_2012_per_shendetin_mendor.pdf

- OSHMA-të nxiten që në bashkëpunim me organizatat që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuar të hartojnë plane të rritjes së aksesueshmërisë në transmetimet audiovizive dhe të ftojnë organizatat të kontribuojnë për të marrë pjesë në realizimin e tyre. (paragrafi i ri)
- AMA dhe Këshilli i Ankesave mundësojnë mënyra miqësore të komunikimit të informacionit për adresimin e kërkesave dhe ankesave të personave me aftësi të kufizuar dhe në veçanti të personave me një shkallë të caktuar paaftësie dëgjimi ose shikimi. (Paragraf i ri)

DRAFT

SEKSIONI X (I RI)

PARANDALIMI DHE LUFTIMI I GJUHËS SË URREJTJES NË TRANSMETIMET

AUDIOVIZIVE⁵⁴

- OSHMA – të nuk përdorin ose përhapin gjuhën e urrejtjes.
- OSHMA-të, promovojnë kulturën e tolerancës dhe mirëkuptimit, respektojnë pluralizmin, informojnë për rreziqet që paraqet gjuha e urrejtjes dhe dekurajojnë përdorimin e saj në media dhe përmes medias.
- OSHMA-të gjatë ofrimit të informacionit të saktë dhe të besueshëm, shmangin përshkrimin stereotip dheposhtërues të individëve, grupeve dhe komuniteteve dhe u japin zë grupeve dhe komuniteteve të ndryshme shoqërore, veçanërisht kur raportohet për çështje me interes të veçantë publik.
- OSHMA-të shmangin identifikimin e kombësisë, fesë, etnisë nëse nuk është e nevojshme dhe rëndësishme në një raportim ose gjatë transmetimit të programeve audiovizive. Gjatë veprimtarisë së tyre informative ato shmangin përdorimin e termave që mund të fyejnë ose ofendojnë një person të një besimi, shtetësie ose kombësie të caktuar.
- OSHMA-të nuk transmetojnë komente, që përmbajnë gjuhë urrejtje, raciste, ksenofobe, homofobe apo transfobe në të gjithë gamën e programeve të veta.
-
- OSHMA -të ndalojnë shpërdorimin e programeve audiovizive nga personat që nxisin urrejtje, dhunë raciste, ksenofobe, homofobe/transfobe, radikalizëm dhe ekstremizëm, promovojnë pikëpamje ekstremiste dhe gjuhën e urrejtjes.
- OSHMA-të parandalojnë dhe ndalojnë dezinformimin, stereotipizimin negativ dhe stigmatizimin e grupeve shoqërore të caktuara.
- OSHMA-të nuk transmetojnë pamje të dhunshme ose veprimtari ku me thirrje ekstremiste.
- OSHMA-të shmangin promovimin e paragjytimeve dhe referencat e panevojshme lidhur me karakteristikat ose statusin personal.
-
- OSHMA-të gjatë programeve informative tregojnë kujdes në përdorimin e termave për shtetasit e huaj, emigrantët ose azilkërkuesit.
- OSHMA-të promovojnë diversitetin dhe dialogun respektin e ndërsjellë dhe mirëkuptimin mbarëshoqëror.

⁵⁴ Disa parime dhe rregulla bazë janë parashikuar në seksionin e parimeve. Me interes gjatë këshillimit publik do të ishte diskutimi për vendosjen më të përshtatshme të këtyre parimeve dhe rregullave.

- OSHMA-të inkurajojnë dhe promovojnë dialogun dhe mirëkuptimin ndërkulturor në programet dhe transmetimet e tjera audiovizive si dhe transemtimet që portretizojnë në mënyrë pozitive dhe mbështetëse diversitetin e zërave dhe burimeve.
- OSHMA-të inkurajojnë dhe transmetojnë reagimin e shpejtë të figurave publike dhe veçanërisht të udhëheqësve politikë, fetarë dhe komunitarë përballë gjuhës së urrejtjes, jo vetëm për ta dënuar, por edhe për ta orientuar atë drejt forcimit të vlerave që gjuha e urrejtjes kërcënon.
- OSHMA-të promovojnë veprimet për të luftuar përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe kontestuar natyrën e papranueshme të saj, duke respektuar lirinë e shprehjes dhe mendimit.
- OSHMA-të krijojnë mekanizmat vetërregullatorë, rishikojnë Kodet e sjelljes dhe miratojnë ndryshimet e nevojshme për të adresuar parandalimi e gjuhës së urrejtjes gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre.
- OSHMA-të inkurajohen të vendosin kufizime ndaj përmbajtjeve me gjuhë urrejtjeje. OSHMA-të mundësojnë trajnimin e përshtatshëm për redaktorët, gazetarët dhe personave të tjerë që punojnë në sektorin e medias mbi natyrën e gjuhës së urrejtjes dhe sesi mund të dekurajohet përdorimi i saj.
- OSHMA-të mundësojnë kanale efektive të raportimit të gjuhës së urrejtjes dhe mes mekanizmave të brendshëm të tyre monitorojnë përdorimit dhe përhapjes së gjuhës së urrejtjes. Në rast të konstatimit të përdorimit të gjuhës së urrejtjes gjatë veprimtarisë audio/ audiovizive, ato duhet të reagojnë, ta dënojnë atë dhe të promovojnë vlerat dhe parimet.
- OSHMA-të reagojnë në rast të konstatimit të përdorimit të gjuhës së urrejtjes gjatë veprimtarisë së vet audio/audiovizive, duke e ndërhyrë për ta ndalur dhe dënuar përdorimin e saj.
- OSHMA-të promovojnë dhe lehtësojnë funksionimin e mekanizmave të ankimit si edhe forcojnë standardet e brendshme favor të gazetarisë etike.

SEKSIONI I RI

PROMOVIMI E BARAZISË GJINORE, PARANDALIMI E LUFTIMI I DISKRIMINIMIT GJINOR NË MEDIAT AUDIOVIZIVE

- OSHMA-të në transmetimet e tyre garantojnë respektimin e dinjitetit njerëzor dhe ndalojnë çdo diskriminim dhe dhunim me bazë gjinore në çfarëdolloj forme të shprehjes së saj.
- OSHMA-ve u ndalohet të përdorin gjuhë urrejtjeje mbi baza seksiste në të gjitha programet, përfshirë edhe reklamat si dhe të promovojnë drejtpërdrejt apo tërthorazi diskriminimin me bazë gjinore.
-
-
- OSSHMA-të angazhohen nëpërmjet programacionit të tyre, të sensibilizojnë opinionin publik për luftimin e diskriminimit me bazë gjinore. Ato shmangin në transmetimet e tyre fajësimin dhe cënimin e jetës private të viktimave të dhunës me bazë gjinore si edhe çdo shkelje tjetër të të drejtave të grave dhe fëmijëve të tyre.
-
-
- OSHMA-të përpiqen për një prani të balancuar të të gjitha gjinive në transmetimet e tyre.
- OSHMA-të nuk favorizojnë objektivizimin seksual, përshkrimin e seksualizuar dhe të racializuar të grave, burrave, vajzave dhe djemve, raportimet nënçmuese ose banalizuese për pamjen, veshjen dhe sjelljen e grave.
- OSHMA -të angazhohen në programet e tyre për ballafaqimin e balancuar, gjithëpërfshirës dhe të mirëinformuar të pikëpamjeve të opinionit të gjerë me synim shmangien e stereotipeve gjinore në mënyrën e adresimit të marrëdhënieve familjare, shoqërore dhe riprodhuese si edhe të dhunës me bazë gjinore.
-
-
- OSHMA-të promovojnë përfaqësimin e ekuilibruar gjinor në programet e tyre në përgjithësi dhe në programet me ndjeshmëri gjinore dhe fokus diskriminimin e shumëfishtë dhe të ndërthurur të grave që i përkasin grupeve shoqërore më të cënueshme në shoqëri.
- OSHMA-të angazhohen për promovimin shembujt pozitivë të grave si pjesëmarrëse aktive në jetën sociale, ekonomike dhe politike, dhe shembujt pozitivë të burrave në role jo tradicionale në shoqëri në të gjitha transmetimet audiovizive, përfshirë reklamat.

- OSHMA ndalojnë transmetimin e reklamave me pamje, role dhe paraqitje stereotipike të grave apo/dhe burrave ose me gjuhë dhe përmbajtje seksiste, të cilat mund të çojnë në diskriminim për shkak të gjinisë, në nxitje të urrejtjes apo/dhe dhunës me bazë gjinore.
- OSHMA inkurajohen të bashkëpunojnë me institucionet e barazisë, organizatat e medias dhe të shoqërisë civile dhe institucionet e specializuara në fushën e barazisë gjinore, për të promovuar portretizimin pozitiv dhe jostereotipe të grave dhe burrave në media dhe në reklama, dhe se si të promovojnë komunikime me ndjeshmëri gjinore⁵⁵.
- OSHMA-të inkurajohen të hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë politika vetërregulluese dhe mekanizma për eliminimin e seksizmit, përfshirë gjuhën e urrejtjes seksiste në programet, reklama, transmetimet dhe në sektorë të tjerë të punës së tyre, duke u mbështetur në standarde ndërkombëtare të gjithëpranuar si Treguesit e Raportimit me Ndjeshmëri Gjinore të UNESCO-s, Udhëzimeve të Këshillit të Europës dhe OSBE-së⁵⁶.

⁵⁵ Ky sugjerim bazohet në rekomandimin (2019)1, paragrafi II.C.6

⁵⁶ Ky sugjerim bazohet në rekomandimin (2019)1, paragrafi II.C.3

REKLAMAT NË TRANSMETIMET AUDIOVIZIVE⁵⁸

- Transmetimi i reklamave nga OSHMA-të duhet të mbajë parasysh kërkesat e legjislacionit në fuqi, veçanërisht për reklamat e ndaluara si dhe reklamat e fshehura (Paragrafi 7.1 i pandryshuar)
- OSHMA-ve u ndalohet të përdorin gjatë transmetimit të reklamave, mënyra të joshjes së shikuesve në mënyrë të pandërgjegjshme dhe teknika për sugjestionimin e tyre. (Paragrafi 7.2 i pandryshuar)
- OSHMA-të nuk duhet të pranojnë apo të transmetojnë reklama që nxisin diskriminimin **për secilin nga motivet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi** apo reklama që nuk respektojnë dinjitetin dhe të drejtat e njeriut. (Paragrafi 7.3 i ndryshuar)
- Reklamat nuk duhet të nxisin ose të shtyjnë fëmijët të blejnë ose të marrin prodhime ose shërbime, duke i nxitur drejtpërsëdrejti për të kërkuar nga prindërit ose personat e afërm t'u marrin mallrat ose shërbimet e reklamuar, ose të shfrytëzojnë pozitën e fëmijëve në raport me prindërit, mësuesit ose persona të tjerë të afërm të tyre. (Paragrafi 7.4 i pandryshuar)
- Reklamat në transmetimet audiovizive për produktet farmaceutike ose produktet mjekësore që jepen vetëm me recetën e mjekut, janë të ndaluara. (Paragrafi 7.5 i pandryshuar)
- **Reklamat për trajtimet mjekësore janë të ndaluara në transmetimet audiovizive.** Ndalohet që mjeku të bëjë reklamë të çfarëdo lloji, me përjashtim të rasteve kur këto kanë qëllim sensibilizues, shkencor ose edukativ. (Paragrafi 7.6 riformuluar fjalia e parë)
- Ndërprerjet për komunikimet me natyrë tregtare në programe të ndryshme duhet të respektojnë kohën e përcaktuar për reklamë në raport me programet e tjera si edhe normat dhe kërkesat e etikës së komunikimit. (Paragrafi 7.6 i pandryshuar)
- Ndalohen reklama dhe promovimi i produkteve të duhanit në transmetimet audio dhe audiovizive.⁵⁹ (Paragrafi i ri)
- Ndalohet çdo lloj forme e reklamimit të produkteve të duhanit, përfshirë promovimin indirekt përmes ngjyrave që përfaqësojnë logot e kompanive ose promovimin nëpërmjet vendosjes dhe ekspozimit të produkteve që imitojnë paketimin e jashtëm të një produkti duhani.⁶⁰ (Paragrafi i ri)

⁵⁷ Në Kodin e transmetimit në fuqi ky seksion është seksioni 7. Në varintian integral, pas konsultimit publik, seksioni do të marrë numërtimin e ri.

⁵⁸ Ligji nr.9636, datë 6.11.2006 "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit"⁵⁸, i ndryshuar, (2013, 2014 dhe 2019) parashikon rregulla në lidhje me reklamat, promovimin dhe sponsorizimin. Sugjerohet që përmbajtja e neneve 13, 14, dhe 14/1 të këtij ligji të pasqyrohen në KT, respektivisht në seksionin për reklamat në transmetimet audiovizive (neni 13 dhe 14) ndërsa përmbajtja e nenit 14/1 që që përmban detyrim për RTSh të parashikohet në një seksion të ri dhe të veçantë për RTSH.

⁵⁹ Ky rregull bazohet në nenin 13&1 të ligjit.

⁶⁰ Ky rregull bazohet në nenin 13&2 të ligjit.

- Ndalohet, botimi për qëllime reklame ose promovimi i fotografive, vizatimeve etj., në të cilat shfaqen persona që pinë duhan si edhe i imazheve që krijojnë përshtypje të gabuar te publiku për karakteristikat dhe efektet e produkteve të duhanit.⁶¹(Paragrafi i ri)
- Ndalohet sponsorizimi i programeve audi dhe audiovizive nga shoqëri që kanë për objekt të veprimtarisë të tyre prodhimin, importimin apo tregtimin e produkteve të duhanit si edhe sponsorizimi i promovimit apo reklamimit të produkteve të duhanit.⁶² (Paragrafi i ri)

⁶¹ Ky rregull bazohen në nenin 13&3 të ligjit.

⁶² Ky rregull bazohen në nenin 14 të ligjit.

SEKSIONI⁶³

KËSHILLI I ANKESAVE⁶⁴

- Këshilli i Ankesave trajton me vëmendje të veçantë ankesat në lidhje me seksizmin në media dhe në reklama dhe kërkon që përmbajtja ose reklama me përmbajtje seksiste të tërhiqet ose të modifikohet.
 - Këshilli i Ankesave në bashkëpunim me organet e barazisë, organizatat e medias, të drejtave të njeriut dhe grave promovon praktikën e mira në lidhje me luftimin e seksizmit dhe stereotipet gjinore në media⁶⁵;
 - Këshilli i Ankesave respekton parimet e barazisë gjinore në vendimmarrjen dhe praktikën e tij në monitorimin e zbatimit të KT dhe të trajtimit të ankesave përsa i përket respektimit të këtij kodi nga OSHMA-të.
- a) Paragrafi 2.3 i këtij seksioni ka nevojë të rishikohet pasi nuk del e qartë sesi trajtohet kjo çështje nga Këshilli i Ankesave. Në vlerësimin tonë, përmbajtja e paqartë paragrafit 2.3 të KT e ka burimin te ligji, konkretisht te neni 20, pika 5 e tij, por kjo mund të tejkalohet duke qartësuar dhe e detajuar në KT. Kjo paqartaësi është theksuar edhe gjatë diskutimit të KT në vitin 2017.⁶⁶
- b) Përmbajtja e pikave 2.4 dhe 2.5 të këtij seksioni nuk janë në harmoni me njëra-tjetrën, përsa i përket anketimeve, shpeshësisë së tyre, detyrimit ose mundësisë së bërjes së tyre dhe periodicitetit të botimit të përfundimeve. Konstatohet se mungesa e harmonizimit e ka burimin tek ligji, konkretisht, te neni 20, pika 6 dhe 7 e tij. Megjithatë, brenda përcaktimeve ligjore, në kuadër të praktikave të mira në fushën e monitorimit të KT, roli i Këshillit të Ankesave për studime mund të rritet; shqyrtimi i ankesave dhe bërja publike e vendimeve në një kohë sa më të shpejt, pse jo të menjëhershme të parashikohet dhe rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut të afishohen në faqen e Këshillit, në mënyrë transparente dhe miqësore për publikun.

⁶³ Në Kodin e Transmetimit në fuqi ky seksion ka qenë seksioni nr.2.

⁶⁴ Sugjerohet që përmbajtja e këtij seksioni të rishikohet duke adresuar më gjerë rolin e Këshillit të Ankesave në monitorimin e këtij kodi dhe duke theksuar rolin pro aktiv të tij në adresimin e problemeve, trajtimin e ankesave dhe rritjen e studimeve dhe informimin në kohë të publikut për vendimarrjet në lidhje me ankesat për zbatimin e KT. Gjithashtu, do të ishte e rekomandueshme që të formulohen edhe disa rregulla për rolin e vet AMA-s në lidhje me Kodin e Transmetimit, që detajojnë kompetencat e parashikuara në ligjin 97/2013.

⁶⁶ Ky konstatim është theksuar edhe në analizën e bërë nga *Dr. Joan Barata Mir*, ekspert i Këshillit të Evropës. Sipas ekspertit, Kodi i referohet përmbajtjes, e cila, në të vërtetë, bie jashtë kompetencës së Këshillit dhe AMA-s në përgjithësi, por në raste të tilla do të ishte më mirë të përcaktohet se Këshilli do të komunikojë dhe raportojë tek autoritetet përkatëse dhe kompetente (në vende të tjera, dhe ndoshta përmes platformave si EPRA), në mënyrë që shkelje të tilla të adresohen siç duhet.

- c) Do të ishte e rekomandueshme që në këtë seksion të përfshihen një - dy paragrafë në lidhje me rolin e KA për përgatitjen e udhëzimeve për trajtimin e ankesave për programet e transmetimit dhe shkeljet e të drejtave të njeriut nga OSHMA sipas kërkesave të parashikuara në nenin 51 të ligjit 97/2013.
- d) Sugjerohet që në rishikimin më të afërt të ligjit 97/2013, të bëhet rishikimi i përmbajtjes së nenin 20, duke mundësuar rritjen e transparencës dhe të bashkëpunimi të të AMA-së me organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në fushë, me botët akademike, sidomos me departamentet e komunikimit në Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL).
- e) Në këtë seksion mund të shtohen edhe roli në vet AMA-së në zbatimin e KT.

DRAFT

SEKSIONI

DISPOZITA KALIMTARE

- AMA, në bashkëpunim ekspertë të pavaruar dhe në konsultim me institucionet publike që veprojnë në fushat që rregullohen nga Kodi i Transmetimit miraton brenda 6 muajve nga miratimi i këtij Kodi, udhëzuesin për zbatimin e tij⁶⁷.
- Brenda 3 muajve nga miratimi i Kodit të Transmetimeve, në zbatim të paragrafit xx të këtij Kodi, OSHMA-të miratojnë formatin e dhënies së lejes me shkrim të prindit ose kudestarit të fëmijës në rastet e përfshirjes së fëmijës në reklamë dhe njoftojnë AMA-në për përmbushjen e detyrimit brenda 15 ditëve nga miratim i saj.
- OSHMA-të hartojnë/ përditësojnë Kodin etik, bazuar në Kosin e transmetimeve dhe rregullat e tjera të miratuara nga AMA.⁶⁸
- OSHMA-të, në zbatim të nenit 42 të legjislacionit në fuqi për median audiovizive dhe paragrafit xx të këtij Kodi, hartojnë/ rishikojnë kodet etike në lidhje me komunikimet e papërshtatshme me natyrë tregtare në transmetimet e tyre, që shoqërojnë ose përfshihen në programet për të mitur, të ushqimeve dhe pijeve, që përmbajnë substanca të dëmshme ose të padobishme për shëndetin fizik të të miturve, veçanërisht ato me përmbajtje të lartë yndyre, acide yndyrore, kripe, sode e sheqeri, që janë tej normave të lejuara për një dietë ushqimore të shëndetshme për të miturit, sipas orientimeve të AMA-s brenda 6 muajve nga miratimi i këtij Kodi.

SEKSIONI

HYRJA NË FUQI DHE PUBLIKIMI

- Kodi i Transmetimit hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Autoriteti i Mediave Audiovizive.
- Kodi i Transmetimit publikohet menjëherë nga Autoriteti i Mediave Audiovizive në faqen zyrtare të internetit: www.ama.gov.al.
- Udhëzuesi i Kodit të Transmetimit i miratuar sipas parashikimeve të paragrafit xx të këtij kodi, publikohet menjëherë nga Autoriteti i Mediave Audiovizive në faqen zyrtare të internetit: www.ama.gov.al.
-

⁶⁷ Për shembull, Qendra Shqiptare për komunikim Publik në vitin 2017 ka hartuar një udhëzues mbi raportimin e ngjarjeve dhe tematikës mbi të miturit në televizionet shqiptare.⁶⁷

⁶⁸ Ky është detyrim ligjor që buron nga ligji 97/2013, i ndryshuar.

ÇËSHITJE PËR DISKUTIM

EDUKIMI MEDIATIK DHE KODI I TRANSMETIMIT – KOHA PËR TË HEDHUR HAPA KONKRETË NGA AMA DHE RTSH

Situata në pak fjalë

Studime dhe raporte të ndryshme vënë në pah se profesionalizmi i mediave në Shqipëri është përkeqësuar me shkelje të shumta etike, sidomos përsa i përket mbrojtjes së fëmijëve, gjuhës së urrejtjes dhe seksizmit në media. Audiencat ndihen të pambrojtura nga abuzimi mediatic në emër të lirisë së mediave dhe shpesh vuajnë në heshtje shkeljen e etikës⁶⁹. Po në këtë studim, theksohet se në lidhje me edukimin mediatic “treguesi i edukimit mediatic i vitit 2018 e rendit Shqipërinë të parafundit në rajon dhe në vendin e tretë nga fundi mes 35 vendeve që u vlerësuan në parametrat e lirisë së shtypit, edukimit dhe besimit ndërpersonal⁷⁰.

Një studim tjetër⁷¹ vë në pah se përpjekjet e edukimit mediatic janë akoma të rralla, mungojnë angazhimet e përbashkëta dhe një vizion i qartë, ndërkohë që mbështetemi akoma tek projektet sporadike.... Megjithatë këto orvatje akoma vazhdojnë, ato kanë qenë të fragmentarizuara dhe kanë angazhuar vetëm një numër të vogël aktorësh; një përpjekje e bashkërenduar e aktorëve të ndryshëm do të siguronte një sukses më të madh të këtyre iniciativave”.

Rëndësia e edukimit për median dhe informacionin

Parandalimi i përhapjes së lajmeve të rreme, disinformimi, i gjuhës së urrejtjes, shkeljes së etikës në programe, informimi dhe cilësia e tij varet nga rregullat dhe standardet që parashikon KT dhe rregulloret e miratuara nga AMA, Kodet e sjelljes së OSHMA, roli i AMA-s si organ rregullator, por edhe roli që luajnë publiku.

Edukimi i publikut për median dhe informacionin (EMI) ndikon në zbatimin më të mirë të KT nga OSHMA. Sipas studimeve⁷², EMI ndikon drejtpërdrejtë në ndërgjegjësimin e audiencave të ndryshme për të drejtat e tyre në raport me organizatat mediatike, për të raportuar rastet e shkeljes së etikës tek AMA ose Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të drejtën e Informimit, për të qenë të kujdesshëm në dhënien e intervistave, të cilat nuk respektojnë të drejtat e të miturve, të viktimave, parimin e prezumimit të pafajësisë, manipulimet e qytetarëve si konsumator të medias. Nga ana tjetër, EMI do të rriste etikën e gazetarëve, cilësinë e medias dhe informimin e publikut. Në ditët tona, kur lajmet e rreme, keqinformimi dhe disinformimi, gjuha e urrejtjes, ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi përbëjnë kërcënime serioze të vlerave të demokracisë dhe të drejtave të njeriut, edukimi mediatic i

⁶⁹ Sulçe -Kolgeci, Valbona: Edukimi mediatic në RTSH-sfidat dhe mundësitë, dokument politikash, Tiranë, 2020, fq. 9.

⁷⁰ Po aty, fq. 3.

⁷¹ Londo, Ilda: Roli i institucioneve publike në zhvillimin e edukimit mbi median dhe informacionin në Shqipëri, Botim i Institutit Shqiptar të Medias, Tiranë 2018, fq.20. Për më shumë shih lexo raportin e plotë në adresën: <http://www.institutemedia.org/wp-content/uploads/2020/03/Roli-i-Institucioneve-Publike-ne-Zhvillimin-e-Edukimit-mbi-Median-dhe-Informacionin-ne-Shqiperi.pdf>

⁷² Sulçe-Kolgeci, Valbona: Edukimi mediatic në RTSH-sfidat dhe mundësitë, dokument politikash, vep. e cituar, fq.9.

publikut, sidomos i të rinjve do të mundësojë një vlerësim dhe analizë të më të mirë të mesazheve mediatike të transmetuara në mediat audiovizive, në internet dhe mediat sociale.⁷³ Në takimet e kryera gjatë përgatitjes së kësaj analize, ekspertë të medias të kontaktuar, theksojnë rëndësinë dhe nevojën e edukimit mediatik.

Baza ligjore për edukimin mediatik

Ka mendime të ndryshme në lidhje me EMI-n në ligjin 97/2013, në veçanti për rolin e AMA-s dhe RTSH si operator publik. Sipas I.Londo⁷⁴ termi edukimi mbi median dhe informacionin nuk përmendet në asnjë dokument politikash ose legjisllacion. AMA nuk e ka zyrtarisht për detyrë të angazhohet me edukimin mbi mediat⁷⁵ dhe Radio Televizioni Shqiptar (RTSH) ka shumë kompetenca dhe funksione të përcaktuara me ligj, por nuk ka ndonjë rol të qartë në lidhje me EMI-n⁷⁶. Në një studim tjetër, theksohet se kuadri ligjor nuk e pengon RTSh-në të angazhohet në veprimtari të edukimit mediatik, përkundrazi i jep gjithë hapësirën e nevojshme për ta realizuar këtë⁷⁷.

Ligji 97/2013, në nenin 18&1, gërma “a” sanksion që AMA në ushtrimin e funksioneve të veta siguron a) që të gjitha shërbimet audiovizive të **përbushin sa më mirë nevojat e qytetarëve** të Republikës së Shqipërisë, duke respektuar gjuhën dhe larminë e traditave, besimeve fetare, kulturës dhe moralit të qytetarëve;

Ndërsa në paragrafin 2 të po këtij neni sanksion se AMA nxit:a) promovimin e programeve të shumëllojshme dhe pa pagesë; c) përbushjen e objektivave nga transmetuesit e shërbimit publik, sipas përcaktimeve të ligjit; ç) rritjen e shumëllojshmërisë së shërbimeve audiovizive;

Edhe kërkesa ligjore (neni 18 &3, gërma “a”) që AMA, në ushtrimin e funksioneve të tij, siguron që marrja e masave përkatëse të jetë në përpjesëtim me objektivat e përcaktuar në këtë nen, respektohet nëse në KT parashikohet edukimi mediatik për RTSH si transmetues publik

Nga ana tjetër, ligji 97/2013 rregullon në mënyrë të veçantë Radiotelevizioni Publik Shqiptar (RTSH) si një një OSHMA që ofron transmetim të shërbimit publik kombëtar (nenet 90- 126).

Deklarata e qëllimit parashikon që RTSH-ja realizon shërbime cilësore radioje dhe televizioni për të informuar, edukuar dhe argëtuar publikun, duke i shërbyer kombit, të gjitha grupeve të shoqërisë, përfshirë dhe pakicat kombëtare (neni 91 i ligjit).

Neni 118 “Qëllimet kryesore të veprimtarisë së RTSH-së” paragrafi 1, gërma “a” dhe ‘ç’ parashikojnë si qëllime kryesore të veprimtarisë së RTSH-së :

*a) t’i përgjigjet **interesave, kërkesave dhe shqetësimeve** të të gjithë popullatës, të mbajë parasysh nevojën për mirëkuptim dhe paqe në Republikën e Shqipërisë e më gjerë, të sigurojë që programet e veta të pasqyrojnë elementet e ndryshme njerëzore dhe kulturore dhe t’i kushtojë vëmendje të veçantë elementeve dalluese të kulturës dhe gjuhës shqipe;*

ç) të sigurojë një gamë të plotë të programeve në gjuhën shqipe, që pasqyrojnë larminë kulturore, argëtojnë, informojnë dhe edukojnë publikun, sigurojnë mbulimin e pasqyrimin të veprimtarive

⁷³ Po aty, fq.10

⁷⁴ Londo, Ilda: Roli i institucioneve publike në zhvillimin e edukimit mbi median dhe informacionin në Shqipëri, vep.e cituar, fq.40.

⁷⁵ Po aty.

⁷⁶ Po aty, fq. 44

⁷⁷ Sulçe- Kolgeci, Valbona: Edukimi mediatik në RTSH-sfidat dhe mundësitë, dokument politikash, vep.e cituar, fq. 14.

sportive, fetare e kulturore dhe plotësojnë pritshmëritë e publikut në përgjithësi, si dhe të individëve, që i përkasin pakicave shoqërore, duke respektuar në çdo rast dinjitetin njerëzor;

KDRTSH miraton Deklaratën e Qëllimit të RTSH-së dhe subjekteve përbërëse të tij, sipas përcaktimeve në statut, lidhur me veprimtaritë e propozuara për t'u realizuar gjatë një afati 5-vjeçar për përmbushjen e qëllimeve të shërbimit të transmetimit publik, si dhe deklaratat njëvjeçare në lidhje dhe në përputhje me Deklaratën e Qëllimit (neni 102, paragrafi 9). Kontrata e shërbimit të transmetimit publik që lidhet me RTSH dhe AMA (neni 117, &2) duhet të parashikojë, natyrën dhe numrin e orëve të programeve të transmetimit për të miturit, shkencën dhe teknologjinë, botimet që duhet të përgatisë, botojë dhe shpërndajë në përputhje me qëllimet e veta RTSH si transmetues publik, përpilimin, publikimin dhe shpërndarjen e materialeve audiovizive, të regjistruara në përputhje me qëllimet e veta si transmetues publik.

Si përfundim, edukimi i publikut është një qëllim kryesor të Deklaratës. Edukimi mediatik është pjesë e këtij edukimi. Analiza e përmbajtjes së neneve 91, 102, 117 dhe 118 të ligjit 97/2013 mundëson edukimin mediatik si pjesë të deklartës dhe qëllimeve kryesore të një trasmetuesi publik.

AMA dhe RTSH- praktika të mira në lidhje me edukimin mediatik

Vlerësimet e veprimtarisë së AMA, në veçanti të Këshillit të Ankesave dhe RTSH tregojnë se ka vullnet të mirë në lidhje me edukimin mediatik. Sipas Londo disa aspekte të punës së AMA-së janë shprehje të edukimit mediatik si: mbledhja e ankesave nga publiku, analizimi i shkeljeve të rregullave etike gjatë raportimit në media. Këshilli i Ankesave dhe administrata e AMA-s në përgjithësi, e kanë pritur mirë idenë e angazhimit më të madh me edukimin mbi median; AMA ka disa vite që bashkëpunon me organizata të ndryshme në fushën e medias, duke mundësuar zbatimin e projekteve për profesionalizmin në media, duke përfshirë këtu edhe edukimin mbi median; AMA luan një rol potencialisht të rëndësishëm për informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut mbi situatën e mediave audiovizive në vend.⁷⁸

RTSH ka patur rezultate pozitive në ndërgjegjësimin e publikut mbi aspekte të veçanta të medias dhe rrjeteve sociale⁷⁹; RTSH ka një Këshill të dëgjuesve dhe shikuesve që mund të kërkojë prej RTSH-së zhvillimin e sondazheve apo studimeve në lidhje me transmetimin e programeve për të rinj dhe minorenë, moshat e thyera, apo grupe të tjera shoqërore⁸⁰. Sulçe në dokumentin e politikave në lidhje me edukimin mediatik dhe RTSH, nënvizion se ka një vendim të Këshillit Drejtues të RTSH-së në maj 2017 për shtimin në programacion të segmenteve për edukimin mediatik; RTSH është i vetmi televizion në vend që ka Parime Editoriale të shkruara, Kodin e Etikës dhe Statut të miratuar. Këto fakte tregojnë se ka vullnet për të forcuar edukimin mediatik, qoftë nga AMA dhe RTSH-ja.

Argumente të tjera të sjella në vëmendje politikbërëse janë se studiuesit dhe politikbërësit mendojnë se mediat publike janë në pozicionin ideal për të ofruar programe të edukimit mediatik, sepse janë media të financuara drejtpërdrejt nga publiku, qoftë nëpërmjet tarifës televizive, qoftë nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe nga ana tjetër, kanë një detyrim ligjor për të informuar, edukuar dhe zbavitur publikun.⁸¹ Nga ana tjetër, Unioni i Transmetuesve Europianë EBU, në një Dokument Pozicioni "Lajmi i rremë dhe

⁷⁸ Ilda: Roli i institucioneve publike në zhvillimin e edukimit mbi median dhe informacionin në Shqipëri, vep.e cituar, fq.41-42.

⁷⁹ Po aty..

⁸⁰ Po aty,

⁸¹ Sulçe- Kolgeci, Valbona: vep, e cituar. fq. 11.

çrregullimi informativ.” (2017) shpjegonte rolin unik që luan media publike për informimin e qytetarëve dhe trajtimin e lajmeve të rreme. Midis rekomandimeve për pavarësinë e mediave dhe cilësinë e gazetarisë, EBU deklaroi se “nismat për edukimin mediatik do të luajnë një rol kyç në luftën ndaj çrregullimit informativ. Mediat publike janë në pozicion kryesor për të përforcuar edukimin mediatik”⁸².

Një nga sfidat që ka nevojë të adresohet, sidomos për RTSH-në, në lidhje me angazhimin në edukimin mediatik janë fondet e mjaftueshme dhe ndërgjegjësimi për edukimin mbi median duhet të bëhet pjesë e detyrave të RTSH-së⁸³. Në vlerësimin tonë, krahas përfshirjes së Komisioneve përgjegjëse parlamentare në këtë proces me qëllim rritjen e buxhetit për RTSH, rëndësi ka forcimi i bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, IAL-të, organizmat vendase dhe ndërkombëtarë që mund të bashkëpunojnë me AMA-n dhe RTSH-në në fillimet e konsolidimit të edukimit mediatik. Rritja e cilësisë së programeve dhe etikës do të ndikojë në rritjen e të ardhurave të RTSH dhe qëndrueshmërinë e programeve të edukimit publik.

Një çështje për diskutim në konsultim publik të Kodit të Transmetimit rekomandohet të jetë çështja nëse në Kodin e Transmetimit mund të parashikohen dy- tre për edukimin mediatik & informimin dhe roli i OSHMA-ve në këtë drejtim.

⁸²<https://www.ebu.ch/publications/fake-news-and-the-information-disorder>

⁸³ Londo, Ilda: Roli i institucioneve publike në zhvillimin e edukimit mbi median dhe informacionin në Shqipëri, vep.e cituar, fq.47.